

**MJESHTËRIA E
ALLAHUT NË
NGJYRA**

HARUN JAHJA

Hyrje: Një botë me ngjyra

Si do të ishte të jetonim një botë pa ngjyra, të errësuar, a keni menduar ndonjëherë? Lirojeni veten tuaj për një moment nga përvoja juaj, harrojeni gjithçka që keni ditur dhe filloni imagjinimin tuaj. Mundohuni që të imagjinoni trupin tuaj, njerëzit rreth jush, detërat, qiellin, pemët, lulet, për shkurt të gjitha në të zezë. Provo të mendosh se si do të ndjeje sikur njerëzit, macet, qenët, zogjtë, fluturat, dhe frutat të mos kishin ngjyrë fare. Ju kurrë nuk do të dëshironit të jetonit në një botë të tillë, apo jo?

Shumica e njerëzve kurrë nuk kanë menduar se në çfarë bote shumëngjyreshe ata jetojnë apo kurrë nuk kanë menduar se çfarë larmi e ngjyrave kanë **ardhur në ekzistencë në tokë**. Ata ndoshta kurrë nuk kanë menduar se si do të ishte bota pa ngjyra. Kjo është ndoshta sepse gjithkush që sheh ka lindur në një botë përplot me ngjyra. Megjithatë, modeli bardhë e zi, pa ngjyra i botës është i pamundur. Në të kundërtën, fakti mahnitës është se ne jetojmë në një botë të ndritshme, me ngjyra. (Në kapitujt vijues, ne do të diskutojmë në detaje pse ekzistimi i botës përplot me ngjyra është aq mahnitës).

Një botë pa ngjyra natyrisht do të imagjinohej vetëm me ngjyrë të zezë, të bardhë dhe hije gri. Megjithatë, e zeza, e bardha dhe hijet gri janë gjithashtu ngjyra. Për këtë arsye është shumë vështirë për njeriun që të imagjinoj pangjyrshmërinë. Edhe kur të imagjinoj pangjyrshmërinë patjetër duhet të përdorë një ngjyrë. Me fjali si “Gjithçka ishte pa ngjyrë, errësirë, nuk kishte mbetur ngjyrë në sipërfaqe, gjithçka ishte e bardhë”, njerëzit mundohen të përshkruajnë pangjyrshmërinë. Në fakt, këto nuk janë përshkrime të pangjyrshmërisë, por të botës bardhë e zi.

Për në çast imagjinojeni që gjithçka rreth jush të humb ngjyrën. Në një rast të tillë gjithçka do të përzihej dhe do ishte e pamundur të dallojmë një object prej tjetrit. Shembull do të ishte e pamundur të shohim një tryezë ngjyrë kafeje, mbi të cilën qëndrojnë një portokall ngjyrë portokalli, ca dredhëza të kuqe apo një buqetë lulesh me lloj-lloj ngjyrash; sepse as ngjyra e portokalltë nuk do të ishte e portokalltë, as tryeza nuk do të ishte ngjyrë kafeje, e as lulet nuk do të ishin të kuqe... Një botë të cilën vështirë mund ta imagjinojmë pa ngjyra, qoftë vetëm për disa çaste të jetojë aty do të ishte mjaft e mërzitshme.

Ngjyra ka një rol kyç në komunikimin e njeriut me botën e jashtme, në funksionimi normal të memories së tij, dhe në mbushjen e trurit të tij **me mësimin e funksioneve**. Kjo është sepse njerëzit mund të zhvillojnë komunikim të përshtatshëm mes ngjarjeve dhe vendeve, njerëzve dhe objekteve vetëm me anë të **ngjyrosjes së trupave**. Për njeriun bota e jashtme ka kuptimin e saj vetëm si një tërësi me ngjyra.

Njohja e objekteve dhe gjërave rreth nesh nuk përfitohet vetëm me anë të larmisë së ngjyrave. Harmonia e përkryer e ngjyrave në natyrë e bën njeriun të ndjejë një kënaqësi në shpirt. Mirëpo këtu duhet të kemi kujdes për një gjë: Njeriu që të shoh këtë harmoni të ngjyrave me të gjitha detajet dhe të ndjejë atë kënaqësi, është pajisur me sytë që janë të konstruktuar në mënyrë të veçantë. Në botën e qenieve të gjalla, sytë e njeriut janë më funksionuesit dhe mund

të perceptojnë ngjyrat në detajet e tyre më të vogla, aq shumë sa syri i njeriut mund të dallojë me miliona ngjyra.¹ Është më se e qartë se aparati vizual në njerëz që punon me aq përsosmëri është i përcaktuar veçanërisht që të shoh një botë përplot me ngjyra.

Qenia e vetme në tokë që mund të kuptojë ekzistimin e një përsosmërie të tillë në univers është njeriu pasi që ka aftësi të mendojë. Kështu që në bazë të gjithë asaj që përmendëm më herët, përfundojmë këtë:

Çdo detaj, mostër dhe ngjyrë në qiej dhe në tokë është krijuar për njerëzit që të falënderojnë dhe të çmojnë këtë renditje dhe të mendojnë për të. Ngjyrat në natyrë janë rregulluar në aso mënyrë që të joshin shpirtin e njeriut. Simetria perfekte dhe harmonia mbizotërojnë në ngjyra, që të dyja në botën e qenieve të gjalla dhe jo të gjalla. Kjo situatë sigurisht do të shkaktojë disa pyetje në mendjen e ndonjërit që mendon, si:

Çka e bën botën të ngjyrosur? Si u krijuan ngjyrat, që e bëjnë botën tonë jashtëzakonisht të mrekullueshme? Kujt i përket dizajnimi i shumëllojshmërisë dhe harmonisë së ngjyrave mes vete?

A është e mundur të themi se gjithçka që ekziston është krijuar nga ndryshimet e paqëllimita të shkaktuara nga një varg të ko incidencave?

Sigurisht që askush nuk do ta pranojë një absurditet të tillë. Ko incidencat e pakontrolluara nuk mund të krijojnë asgjë, e lëre më miliarda të ngjyrave. Vetëm vërejtje krahët e fluturës apo ngjyrat e luleve të ndryshme, secila prej tyre duket si mrekulli e artit. Sigurisht është e pamundur për tingullin e arsyes që këtotribute të ia lë proceseve të pavetëdijshme.

Ne do t'i kuptojmë këto fakte më mirë nëse marrim një shembull. Nëse ndokush sheh një pikturë që përshkruan pemët dhe lulet në natyrë, njëri nuk do të pohonte e as të mendonte se harmonia e ngjyrave, modelet e organizuara dhe dizajnimi i vetëdijshëm në pikturë kanë mundur të krijohen nga ko incidencia. Nëse dikush del dhe thotë, "se kutitë e bojërave janë asgjësuar nga era, janë përzier, dhe me forcën e shiut etj., dhe pas një periudhe të gjatë kohore kjo pikturë e mrekullueshme është krijuar", është më se e sigurt se askush nuk do të marrë këto fjalë seriozisht. Është një situatë interesante këtu. Megjithatë askush nuk do të pranonte të shprehë një pohim kaq të paarsyeshëm, disa njerëz prapë se prapë deklarojnë se ngjyrosja e përkryer dhe barazia e natyrës është krijuar nga procese të pavetëdijshme, të pavullnetshme. Sidoqoftë, evolucionistët japin këso ide që thonë që është puna e ko incidencës së rastit për të shpjeguar këtë lëndë dhe japin hulumtime të ndryshme. Ata nuk hezitojnë të japin përfundime të pabaza mbi këtë çështje.

Qartë kjo është verbëri, me anë të së cilës është mjaft vështirë të arrihet në *term*. Ende, dikush që ikë nga kjo verbëri duke shfrytëzuar aftësinë e mendimit do të kuptojë se aktualisht ai është duke jetuar në një mjedis jashtëzakonisht të mrekullueshëm në tokë. Ai do të vërtetojë tërësisht dijen e tij që një mjedis i pajisur me rrethanat më të përshtatshme për mbijetesën e njerëzimit nuk ka mundur të krijohet rastësisht.

Vetëm si një njeri që mendon, pranon momentin që shikon në pikturë që ka piktorin e saj, kështu që ai do të kuptoj se mjedisi shumëngjyrësh rreth tij , i harmonizuar dhe jashtëzakonisht piktoresk po ashtu ka një **Krijues**.

Ky **Krijues**; që nuk ka shoq në krijim, që gjithçka ka krijuar në një harmoni të përsosur, që neve na ka dhënë bukuri shumëngjyrëshe në këtë botë është **Allahu**. Çdo gjë që ka krijuar **Allahu** është në një pajtueshmëri, harmoni mes vete. **Allahu** mjeshtërinë e tij të pashoqe të krijimit në ajetet e Kuranit kështu e përmend:

Ai është që krijoi shtatë qiej palë mbi palë. Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë kontrast, andaj, drejto shikimin se a sheh ndonjë çarje? Mandej, herë pas herë drejto shikimin, e shikimi do të kthehet te ti i përulur dhe i molisur. (Suretu El Mulk: 3-4)

Çka është ngjyra? Si është krijuar?

Disa detaje kanë një vend të rëndësishëm në mendjen e njeriut dhe kurrë nuk ndryshojnë. Le të fillojmë me pemët, të cilat janë të njohura për ne. Ngjyra e pemëve zakonisht është ose gjelbër ose e gjelbër e hijezuar. Mirë e dimë se gjatë vjeshtës, gjethet ndërrojnë ngjyrën. Ngjashëm, ngjyra e qiellit është ose e kaltër, ose me ngjyrë gri e hijezuar kur është vrenjtur ose e verdhë dhe e kuqe në agim dhe muzg, në lindje dhe në perëndim të diellit. Ngjyra e frutave kurrë nuk ndryshon; ngjyrat e larmishme të kajsisë dhe vishnjës janë të caktuara, dhe si të tilla gjithnjë janë të njohura. Shkurt, çdo gjë e gjallë dhe qenie që është nën dritë ka ngjyrë. Vështroni gjërat rreth juve me vëmendje. Çfarë shihni? Tryeza, karriget, pemët që i shihni përtej dritareve, qielli, muret e shtëpisë suaj, fytyrat e njerëzve rreth jush, frutat që i hani, librin që jeni duke e lexuar në këtë moment... Çdo njëra prej tyre ka ngjyrë të veçantë. A keni menduar ndonjëherë se si është e mundur që të gjitha këto ngjyra të krijohen dhe rregullohen me aq përsosmëri?

Le të shohim se çka është e nevojshme për t'u krijuar këto ngjyra, të cilat kanë një rol mjaft të rëndësishëm në jetën tonë. (Këto çështje do t'i diskutojmë më vonë në detaje). Për krijimin e një ngjyre të vetme, p.sh., të kuqe ose të gjelbër, të gjitha proceset që do t'i përmendim duhet të ndodhin dhe, më me rëndësi në këtë renditje:

1. Kushti i parë për krijimin e ngjyrës është ekzistimi i dritës. Për këtë arsye do të ishte me më dobi të fillojmë të ekzaminojmë karakteristikat e dritës që vjen nga dielli. Për të krijuar ngjyrën, drita që vjen nga dielli në tokë duhet të ketë gjatësi valore të caktuar që të prodhojë ngjyrat. Dimensionet e dritës, që quhen “dritë e dukshme”, në të gjitha rrezet e dritës të emetuar nga dielli është një në 10^{25} . Ky dimension i imët dhe vështirë i besueshëm i rrezeve të dritës që është i nevojshëm për krijimin e ngjyrës, mbërrin në tokë nga dielli.

2. Në fakt, këto rreze diellore të shpërndara nga dielli nëpër kozmos shfaqin disa karakteristika të dëmshme për sy. Për këtë arsye, drita që arrin në tokë duhet të merr një formë e cila do perceptohej lehtë nga syri dhe nuk do ta dëmtonte atë. Për këtë, rrezet duhet të kalojnë nëpër një filtër. Ky filtër gjigant është “atmosfera” që e mbështjell tokën.

3. Drita që kalon nëpër atmosferë shpërndahet në tokë, dhe kur ndeshet me objekte të ndryshme, ajo reflektohet. Objekti mbi të cilin bie drita nuk duhet të jetë objekt që absorbon dritën por që e reflekton atë. Me fjalë të tjera, cilësia strukturore e objektit duhet të jetë në pajtueshmëri me dritën që arrin në tokë, në mënyrë që të formohet ngjyra. Ky kusht duhet të plotësohet dhe një valë e re e dritës reflektohet nga objekti në të cilin është ndeshur drita që ka ardhur nga dielli.

4. Edhe një hap thelbësor është i nevojshëm në procesin e formimit të ngjyrës për perceptuesin që të perceptoj valët e dritës, e që është syri. Është esenciale që edhe valët e dritës të jenë në harmoni me organet e të pamurit.

5. Rrezet që vinë nga dielli duhet të kalojnë nëpër thjerrë dhe shtresë të syrit që të shndërrohen në impulse nervore në retinë. Pastaj këto sinjale duhet të shndërrohen në “qendrën e shikimit” në tru, që është përgjegjëse për prodhimin e ndjenjës së pamjes.

6. Është edhe hapi i fundit që duhet të përmbushet që ne “të shohim” ndonjë ngjyrë. Faza e fundit në krijimin e ngjyrave është interpretimi i sinjaleve elektrike, të cilat vinë nga qendra e shikimit në tru, si “ngjyra” nga qelizat e një nervi special të lokalizuar aty.

Siç pamë, për formimin e një ngjyre të vetme, nevojiten procese shumë të detajizuara dhe të ndërvarura.

Gjitha informatat që i kemi për ngjyrën dëshmojnë se secili proces që ndodh gjatë formimit të ngjyrës është me një balancim shumë delikat. Po të mos ekzistonin këto balancime, ekuilibre, ne në vend se të jetojmë në një botë normale, do të jetonim në një botë të errët dhe të turbullt, e edhe do të humbnim aftësinë e të pamurit. Nga gjërat që i përmendëm më lartë të supozojmë mosekzistim e vetëm një, qelizave nervore të retinës që perceptojnë sinjalet elektrike. As drita e diellit nuk do të ishte e mjaftueshme, as pjesët e tjera të syrit nuk do të ishin funksionale, e as ekzistenca e atmosferës nuk do ta kompensonte mungesën e qelizave nervore të retinës.

Roli i Retinës në të Pamurit

Le ta ekzaminojmë retinë për së afërmi dhe më në detaje. Le të supozojmë se mungon substanca e quajtur pigmenti “rodopsin”. Rodopsina është substancë që punon pandërprerë në dritë të fortë por rigjenerohet në errësirë. Syri nuk mund të shohë qartë në dritë të zbehtë pa prodhimin e sasisë së mjaftueshme të rodopsinës në sy. Detyra e rodopsinës është që të rrit efektivitetin me të cilën syri gjeneron impulse nervore nga drita e zbehtë. Kjo substancë prodhohet aq sa është e nevojshme dhe atëherë kur është e nevojshme për syrin. Kur mbahet ekuilibri i rodopsinës, figura qartësohet. Çka do të ndodhte sikur rodopsina, që ka një rëndësi të madhe në procesin e të pamurit, të mos ekzistonte? Në ato rrethana, njeriu do të ishte i aftë të shohë vetëm në dritë të kthjelltë, në ambient të ndritshëm.² Është më se e qartë se ekziston një sistem i përkryer në sy, që është dizajnuar deri në detajet më të imta.

Atëherë, kush e punoi artin e këtij sistemi, që na mbron neve nga errësira dhe na shfaq neve një botë përplot me ngjyra?

Çdo etapë e përmendur tregon se ekziston një seri e proceseve, për të cilat nevojitet ekzistenca e mençurisë, e dëshirës dhe e forcë që ka krijuar këto procese. Është e dukshme se nuk ka gjasa që një varg i proceseve që ekzistojnë në një harmoni të këtillë të jetë krijuar nga rastësia. Po ashtu është e pamundur për një sistem të tillë të formohet nëpër një periudhë kohore të gjatë. Rezultatet nuk do të ndryshonin edhe sikurse të kalonin miliona e miliardë vite. Sistemi i përbërë nga një botë shumëngjyrëshe kurrë nuk to shfaqej nga koincidenca. Një sistem i tillë do të krijohet vetëm si rezultat i një dizajni special, që e dinë që ai është krijuar. Allahu zotëron forcë të përhershme dhe urtësi e tij mbulon universin. Shembuj në mjeshtërinë e

pakrahasueshme të Allahut kemi gjerë e gjatë në univers. Dizajnimi unik që është evident në formimin e ngjyrave po ashtu është rezultat i krijimtarisë së pashoqe të Allahut. Allahu ka forcë mbi çdo gjë.

Ai është shpikësi i qiejve e i tokës e kur dëshiron diçka, ai vetëm i thotë: “Bëhu!” në atë moment bëhet. (Suretu El Bekare, 117)

Dizajni në ngjyra

Ngjyra është koncepti që na ndihmon neve në identifikimin e veçorive të objekteve dhe përcaktimin më të saktë të tyre. Njeriu që do të vërente dhe do të mendonte një nga një për ngjyrat e objekteve rreth nesh lehtë do të vërente se është i rrethuar me ngjyra me detaje shumë të ndryshme. Të gjitha qeniet, të gjalla apo të vdekura e kanë nga një ngjyrë. Për më shumë, të gjitha qeniet e një lloji kanë të njëjtën ngjyrë në mbarë botën, kudo që të gjenden. Shkoni ku të shkoni, ngjyra e shalqirit do të jetë e kuqe, kivitë kanë ngjyrë të gjelbër, detërat janë të kaltër, bora është e bardhë, limonët janë të verdhë, ngjyra e elefantëve është e njëjtë në të gjithë botën, sikurse që është e njëjtë edhe ngjyra e drunjëve. Ato kurrë nuk ndryshojnë. Kjo vlen edhe për ngjyrat e prodhuara artificialisht. Kudo që të shkosh në botë, nëse e përzien të kuqen me të verdhë, do të fitosh ngjyrën e portokalltë, apo nëse e përzien të zezën me të bardhën ju do të fitoni të përhirtë. Rezultati është i njëjtë.

Në këtë pikë, do të ishte e dobishme të mendonim diçka më ndryshe. Së pari, le të mendojmë duke pyetur se si janë krijuar ngjyrat e objekteve. Këtë do të mund ta shpjegojmë me një shembull. Imagjinoni se je duke hyrë në shitore, apo depo dhe shini pëlhura të dizajnëve dhe modeleve të ndryshme, ngjyrat e të cilave janë tepër të ngjashme me njëra tjetrën. Kuptohet, ato pëlhura aty nuk kanë ardhur rastësisht; njerëzit me dashje i kanë skicuar dizajnet e tyre, kanë vendosur ngjyrën e tyre, i kanë nënshtruar ato në një numër procese për lyrje, dhe pasi i kanë vendosur ato në etapa të ndërmjetshme, ata i kanë ekspozuar ato në dyqane. Shkurt, ekzistimi i këtyre pëlhurave varet nga njerëzit që i kanë dizajnuar dhe i kanë prodhuar ato. Kur i sheh ato pëlhura, di nuk thua se ato erdhën aty rastësisht, apo se skica e tyre nuk është dizajnuar nga koincidenca si rezultat i ndarjes së ngjyrave në pëlhura. Në fakt, asnjë njeri i arsyes nuk do të thoshte një përfundim të tillë. Në të vërtetë, është një Urdhërues që na prezanton neve pamjet që i shohim në natyrë tërë kohën, fluturat, lulet, vendet e shumëngjyrosura nën det, pemët, dhe retë etj., në të njëjtën mënyrë se si na janë prezantuar neve këto pëlhura. Larmia e ngjyrave në natyrë është pasojë e dizajnit special. Ky dizajni manifestohet në çdo etapë të formimit të dritës deri te formimi i një imazhi të ngjyrosur në trurin tonë. Kjo është njëra nga dëshmitë më të mëdha të Zotëruesit, që është, Dizajnues i dizajnit të ngjyrave. Sigurisht, Allahu, Që posedon mençuri dhe forcë të pakufishme të krijimit, krijon të gjitha ngjyrat dhe dizajnet në univers që njeriu i admiron.

Etapa e formimit të ngjyrës shkurtimisht u përmendën më herët. Në këtë kapitull,

1. Drita, Jeta dhe Ngjyra

Dielli është vetëm njëri prej miliarda yjeve të madhësisë mesatare në univers. Ajo që e bën diellin njërin prej yjeve më të rëndësishme në univers është madhësia e tij, marrëdhëniet e tij me planet që lëvizin rreth tij dhe rrezet e imëta që i emeton. Nëse vetëm njëra nga këto karakteristika të diellit të ishte më ndryshe, në tokë nuk do të kishte jetë. Në të vërtetë, dielli ka

aftësitë që të krijojë jetën dhe ta vazhdoj atë në tokë.³ Kjo është arsyeja pse shkencëtarët e përshkruajnë diellin si “burim i jetës” në tokë.

Drita e diellit është i vetmi burim i nxehtësisë, që e ngrohë tokën në mënyrën më të përshtatshme, dhe drita, që i ndihmon bimët në fotosintezën e tyre. Është mirë e njohur se ngrohtësia dhe fotosinteza janë esenciale për jetë. Veç kësaj, ekzistenca e dritës dhe e botës me ngjyra varet nga emetimi i rrezeve nga dielli. Në këtë rast, shtrohet pyetja se si krijohen këto rreze, që janë burim themelor i energjisë në tokë. Këto rreze që janë çelës i jetës në tokë, që kryejnë funksione aq të rëndësishme, dhe atë në të njëjtën kohë, i kanë të gjitha vetitë për të kryer këtë, nuk mund të konsiderohen se janë krijuar nga koincidenca. Shkaku i këtyre do të kuptohet më mirë kur të hulumtohet më mirë struktura e dritës.

Energjia e emetuar nga yjet lëviz nëpër boshllëkun e gjithësisë në formë të valëve. Ngjashëm, edhe drita edhe nxehtësia emetohen nga dielli, që është yll, si e energji në formë të valëve. Lëvizja e kësaj energjie të emetuar nga yjet, mund të krahasohet valët që shkaktohen nga hedhja e një guri në liqen.

Vetëm se valët në liqen kanë gjatësi të ndryshme, ashtu edhe nxehtësia dhe drita kanë gjatësi valore të ndryshme gjatë shpërhapjes.

Në këtë pikë, do të ishte e dobishme që të japim disa informata lidhur me gjatësi valore të ndryshme të dritës në univers. Yjet dhe burimet e tjera të dritës në univers nuk emetojnë të njëjtin lloj të dritës. Këto rreze të ndryshme klasifikohen sipas gjatësisë së tyre valore dhe frekuencës. Këto gjatësi valore janë të shpërndara në hapësira të pafundme. Për shembull, gjatësia valore më e shkurtër është 10^{25} herë më e shkurtër se gjatësia valore më e gjatë (10^{25} është një numër mjaftë i madh që përbëhet nga numri 1 i renditur para 25 zerove).⁴

Në gjithë spektrin, të gjitha rrezet e emetuara nga dielli janë të shtrydhura në interval kohor të shkurtër. 70% e gjatësive valore të ndryshme që emeton diellin shtrihen mes kufirit intervalor prej 0.3 mikronëve deri në 1.50 mikronë. (Një mikron është 10^{-6} m) Duke hulumtuar përse rrezet e diellit janë të kufizuar në një interval aq të vogël, ne arrijmë deri te një konkluzion interesant: të vetmet rreze që mundësojnë jetën, dhe ngjyrën, në tokë janë ato që gjenden brenda këtij intervali.

Fizikani britanik Ian Campbell, që e definoi këtë dizajn superior si “mosbesueshmërisë mahnitës” në librin e tij “*The Energy and the Atmosphere*”, i vuri vëmendje kësaj pike:

Se rrezatimi prej diellit (dhe prej shumë yjeve tjera) duhet të jetë i koncentruar në bendin e vockël të spektrit elektromagnetik, i cili jep saktësisht rrezatimin që nevojitet për zhvillimin e jetës në tokë, është shumë koincidence.⁵

Pjesa më e madhe e këtij rangu të vogël të rrezatimit emetohet nga dielli prej spektrit elektromagnetik, spektri që ka gjerësi ku gjatësia valore më e gjatë është 10^{25} herë më e gjerë se më e vogla, quhet “spektër i dukshëm”. Rrezet që shtrihen nën dhe mbi këtë interval, në

3

4

5

tjetër anë, arrijnë në tokë si rreze infra të kuqe dhe rreze ultravjollce. Le të ekzaminojmë tani karakteristikat e këtyre dy rrezeve.

Rrezet infra të kuqe në tokë arrijnë në formë të valëve nxehta. Rrezet ultravjollce që përmbajnë energji më të lartë, në anën tjetër, mund të kenë efekt dëmtues në qeniet e gjalla. Rrezet infra të kuqe kalojnë nëpër atmosferë, dhe sigurojnë ngrohtësinë, që e bën tokën vend të përshtatshëm për jetë. Rrezet ultra vjollce, në anën tjetër, mund të arrijnë në tokë vetëm me masë të caktuar. Nëse kjo masë do të ishte vetëm pak më e lart se ç'është tani, do të shkatërronte lëkurën e qenieve të gjalla dhe do të shkaktonte vdekje masive, për derisa po të ishte pak më e ulët, atëherë nuk do të sigurohej energjia e nevojshme për jetë.

Këto pika janë detajet kritike, vendimtare për jetë. Siç kuptuam nga funksionet dhe dobia e rrezeve të emetuara nga dielli, ekziston një rend dhe kontroll në çdo sistem ekzistues në botë. Sigurisht, është e pabesueshme për një sistem të tillë, balanca mjaft delikate e të cilave do të bëhej për një kohë të shkurtër, të jetë formuar nga koincidenca.

Duke hulumtuar një element tjetër në këtë sistem të përsosur, ne edhe një herë e shohim pamundësinë që ai element të ekzistoj si rrjedhojë e koincidence.

2. Mburoja që mbron tokën: Atmosfera

Në faqet e mëparshme, ne përmendëm që disa prej rrezeve të diellit janë të dëmshme për zhvillimin e jetës në tokë. Në mënyrë që të shmangemi nga kjo dukuri, nevojitet të gjejmë një zgjidhje.

Le të i bashkojmë kokat tona dhe të gjejmë një zgjidhje për këtë problem duke zhvilluar një sistem efikas që të filtroj rrezet e diellit. Ne po ashtu duhet të kemi parasysh se ky sistem duhet të jetë një sistem multifunksional, që do të mbron tokën nga efektet e dëmshme të rrezeve të diellit, duke u siguruar që ky sistem të jetë përherë i mbrojtur, pa pasur nevojë riparimi, dhe gjithashtu i aftë të parandalojë disa kërcënime tjera për tokën. Padyshim, se në aso situata disa zgjedhje alternative do të dilnin në sipërfaqe. Akoma, asgjë nuk është shprehur se mund të jetë një filtër efikas dhe i gjithanshëm si filtri i tanishëm që sot mbron tokën: atmosfera. Atmosfera e tokës është një filtër qind për qind i suksesshëm që filtron rrezet dëmtuese të diellit dhe Allahu e ka dizajnuar atë në mënyrë të posaçme për të mbrojtur tokën.

Me anë të mënyrave të specifike të shtresave të atmosferës, rrezet arrijnë në tokë në sasi të mjaftueshme sepse atmosfera i shqyrtojnë rrezet specifike duke sipas gjatësisë valore të tyre. Atmosfera jonë është si një bimë pastruese gjigante e dizajnuar për filtrimin e këtyre rrezeve. Ky sistem pastrues gjigant që nuk të njëjtë me të në tokë është duke i zhvilluara këto procese për shkak të dizajnit special të tij. Allahu ka përmendur krijimin e qiejve siç vijon:

S'ka dyshim se krijimi i qiejve dhe i tokës është më i madh se krijimi i njerëzve, por shumica e njerëzve nuk e dinë këtë. (Sure Gafir:57)

Rrezet që vijnë nga dielli janë krejt të veçanta. Është e nevojshme për ato që të posedojnë disa karakteristika që i mundësojnë atyre të kalojnë në atmosferë dhe të arrijnë në

tokë. Ngjashëm, atmosfera, po ashtu, duhet të ketë strukturë të veçantë që të lejoj këto rreze të kalojnë nëpër të. Përndryshe, as ekzistimi i atmosferës e as përshtatja strukturale e rrezeve do të ishte e dobishme. Për shkak të natyrës së atmosferë që lejon depërtimin e rrezeve në të, rrezet që vijnë nga dielli e arrijnë tokën me lehtësi. Këtu është edhe një pikë tjetër interesante që duhet përmendur. Derisa atmosfera lëshon të depërtoj vetëm dritën e dukshme dhe gati rreze infra të kuqe të nevojshme për jetë, ajo pengon të gjitha rrezet tjera destruktive të arrijnë tokën. Atmosfera e tokës shërben si një filtër shumë i rëndësishëm i tokës për rrezet destruktive që vijnë nga dielli apo burime e tjera të dritës, që është prej zonave të tjera në gjithësi.⁶

Michael Denton, një astronom i famshëm, konstaton se:

*Gazrat e atmosferës të gjitha rrezet përveç rrezeve të dritës dhe rrezeve gati infra të kuqe të gjitha rrezet e tjera i absorbojnë në një mënyrë të fortë. Nëse vemi re, shohim se i vetmi spektër që lejohet të kaloj nëpër atmosferë në gjithë kufirin e rrezatimit elektromagnetik që nga rrezet radio deri rrezet gama është rrezet e dritës dhe rrezet gati infra të kuqe. Praktikisht nuk ka rreze gama, rreze X, rreze ultravjollce, infra të kuqe-larg, dhe rreze mikrovalore që arrin mbi sipërfaqe të tokës.*⁷

Është e qartë se në strukturën e atmosferës është përdorur një dizajnimi i zhvilluar në shkallën më të lartë që ekziston. Jashtë spektrit gjerësia të aluduar në këtë figurë është , dielli emeton ato rreze që janë të dobishme dhe të nevojshme për të pasur një botë shumëngjyrëshe, dhe atmosfera i lejon të depërtojnë kryesisht ato rreze të padëmshme dhe në të vërtetë të dobishme për të arritur tokën. Veç kësaj, për shkak të karakteristikave të gazrave që janë prezent në atmosferë, sytë e qenieve të gjalla, që janë të ekspozuar drejtpërdrejt dritës së diellit janë të mbrojtur nga efektet e dëmshme të këtyre rrezeve. Gjitha këto janë evidenca se Allahu ka krijuar çdo gjë në proporcion të caktuar.

Ai është që vetëm Atij i takon sundimi i qiejve dhe i tokës, Ai nuk ka as fëmijë e as nuk ka shok në sundimin e Tij. Ai krijoi çdo gjë, duke e përsosur në mënyrë të qartë e të matur. (Suretu El Furkanë:2)

3. Drita që godet lëndën

Drita që vjen nga dielli e arrin tokën me një shpejtësi prej 300.000 km në sekondë. Në sajë të shpejtësisë së dritës në gjithnjë shohim një botë përplot me ngjyra. Atëherë, si krijohet një imazh i pandërprerë?

Duke kaluar nëpër atmosferë me një shpejtësi vigane, drita arrin tokën dhe godet objektet që gjenden në të. Kur drita godet apo ndeshet me objektin në një shpejtësi kaq të madhe, ajo bashkëvepron me atomet e atij objekti dhe reflekton gjatësi valore të ndryshme që i përgjigjen ngjyrave të ndryshme. Në këtë mënyrë, librin të cilin jeni tani duke e mbajtur, vijat e tij, figurat e tij, pamjen që e shihni kur shikoni jashtë, pemët, ndërtesat, makinat, qielli, zogjtë, macet, shkurt gjithçka ju e shihni reflekton ngjyrën e saj përkatëse.

6

7

Molekulat që mundësojnë që këto ngjyra të reflektohen janë molekulat e pigmenteve. Kjo është ajo, ngjyra reflektohet në varësi se çfarë molekula, molekulat e cili pigmente janë prezentë në atë objekt. Çdo molekulë e pigmenteve ka strukturë të ndryshme atomike. Numrat atomik, si dhe llojet dhe rendimi i atomeve në këto molekula është i ndryshëm. Drita që godet pigmentet në mënyra të ndryshme reflektohet në hije të ndryshme të ngjyrave. Sidoqoftë, kjo nuk është e mjaftueshme për krijimin e ngjyrës. Për dritën e reflektuar që përmban kualitetin e caktuar të ngjyrës për perceptimin dhe pamjen e saj, nevojitet që ajo të arrijë deri te ndonjë organ apo aparat i aftë ta perceptoj atë.

4. Drita që vjen në sy

Për rrezet e reflektuara nga objektet që të perceptohen si ngjyra, është e nevojshme për ato që të arrijnë syrin. Ekzistimi i syrit vetëm, nuk është i mjaftuar. Pasi të arrijnë syrin, rrezja duhet të shndërrohet në sinjal nervor që arrin në tru duke punuar në harmoni me sytë.

Le të mendojmë për sytë dhe trurin tonë si shembuj më të afërt. Syri i njeriut ka një strukturë shumë komplekse që përbëhet prej disa organeleve dhe pjesëve të ndryshme. Si rezultat i funksionimit të gjitha këtyre pjesëve menjëherë dhe në harmoni, ne shohim dhe perceptojmë ngjyrat. Syri, me indin dhe organelet e tij siç janë gjëndra e lotëve, kornea, konjunktiva, irida dhe bebëza, thjerrëza, retina, koroidi, muskujt dhe kapaku i syrit, është një sistem i pangjashëm, i pakrahasueshëm me ndonjë sistem tjetër. Në mbledhje, me rrjetin nervor të posaçëm që vendos lidhjen në tru, dhe një hapësirë vizuale të jashtëzakonshme, syri, si një vrimë, ka një strukturë të veçantë, ekzistimi i së cilës nuk mund të jetë atribut i koincencës.

Pas një njohje të shkurtër për syrin, se si ndodh procesin i të pamurit. Rrezet e dritës arrijnë në sy vetëm pasi të kalojnë në kornea, pastaj në bebëz dhe në thjerrëz, dhe për të arritur në fund retinën.

Perceptimi i ngjyrës fillon në qelizat në formë koni në retinë. Janë tri grupe themelore të qelizave konike që reagojnë me fuqi ndaj ngjyrave të caktuara të dritës. Këto janë të klasifikuara si konet e ngjyrës të kaltër, e ngjyrës të gjelbër, dhe konet e ngjyrës të kuqe. Ngjyra e kuqe, e kaltër dhe e gjelbër, në të cilat reagojnë qelizat konike, janë tri ngjyrat primare që ekzistojnë në natyrë. Me stimulimin e qelizave konike, të cilat janë të ndjeshme ndaj këtyre ngjyrave, në shkallë të ndryshme, neve na paraqiten miliona ngjyra të ndryshme.

Qelizat konike e shndërrojnë këtë informatë që i takon ngjyrës në impulse nervore me anë të pigmentit që ato përmbajnë.⁸ Pastaj, qelizat nervore që janë të lidhura me këto qeliza konike bartin impulse nervore në vend të caktuar në tru. Vendi ku bota shumëngjyrëshe që ne e shohim formohet në këtë hapësirë në tru që ka madhësi prej vetëm disa centimetrave katrorë.

5. Bota shumëngjyrëshe në trurin tonë të errët

Etapa përfundimtare e formimit të ngjyrës ndodhë në trurin tonë. Siç e përmendëm në kapitullin e kaluar, qelizat nervore në sy bartin imazhet e shndërruara në impulse nervore në tru

dhe gjithë çka ne shohim në botën e jashtme perceptohet në qendrën vizuale në tru. Në këtë pikë. Ne ndeshemi me një fakt mahnitës: truri është një pjesë mishi plotësisht e errët në brendësi. Imazhet e objekteve, me ngjyrat e tyre si dhe me të gjitha karakteristikat e tyre, janë formuar si perceptime në qendrën vizuale. Si ndodh që ky proces i perceptimit të zhvillohet në një vend të atillë që është një pjesë mishi të butë?

Shumë pyetje kyçe mbesin se si ngjyrat perceptohen. Kromatikët akoma nuk janë në gjendje të japin përgjigje në pyetjen se si impulsset nervore transmetohen në tru me anë të nervave optik dhe çfarë lloj efekte psikologjike krijojnë ato në tru.⁹ Gjithë çka ata dinë është se perceptimi i ngjyrës, që është fakt, ndodhë në brendinë tonë, e që është qendra vizuale në trurin tonë.¹⁰(Për informata më të detajizuara, shikoni kapitullin *Fshehtësia përtej materies*)

Në fakt, shumica e proceseve që ndodhin në tru ende nuk janë të sqaruara. Sqarimet e subjekteve janë të bazuara kryesisht në teori. Sidoqoftë, truri i përmbushë në mënyrë të përkryer të gjitha funksionet e veta që nga momenti kur ka filluar të ekzistoj njeriu, ashtu siç i kryen sot. Eksperienca njerëzore në botën tridimensionale, së bashku me të gjitha ngjyrat e saj dizajnët, zërat, erërat dhe shijet, në një pjesë mishi me peshë afro një kilogrami është bërë e mundur vetëm me krijimtarinë e përkryer të Allahut. Gjithkush e gjen këtë mrekulli të pangjashme të gatshme në lindje. Njeriu nuk ka kontroll mbi çfarëdo qoftë, as në formimin e funksioneve të tij, as në vijueshmërinë e tyre, e as në çfarëdo etape tjetër.

Molekulat që prodhojnë ngjyrën: Pigmentet

Në kapitujt e kaluar, ne përmendëm se si shkak i karakteristikave të ndryshme atomike në molekulat pigmentuese, objektet reflektojnë rreze të ndryshme të ngjyrës; kështu që, krijohen hije të ndryshme të ngjyrave. Shikoni edhe njëherë rreth vetes. Sa ngjyra shihni aq pigmente ekzistojnë, sepse ngjyra e çdo materie është rrjedhojë e pigmentit që gjendet në atë materie. Ngjyra e gjelbër e bimëve, ngjyra e lëkurës, ngjyra e kafshëve, shkurt të gjitha ngjyrrat rrjedhin nga karakteristikat strukturale të pigmenteve që përmbajnë në vete këto objekte.

Ç'është pigmenti?

Pigmentet, që të dyja që ekzistojnë edhe në sy edhe në sipërfaqet e objekteve të jashtme, janë molekula të veçanta që japin ngjyrën. Nevojitet një energji e caktuar që të aktivizohen këto pigmente. Saktësisht, sikurse në të gjitha etapat e formimit të ngjyrës, edhe këtu gjendet një harmoni e përkryer në mes të pigmenteve dhe dritës. “Drita e padukshme” që arrin në tokë është e dizajnuar veçanërisht për molekulat e “pigmenteve”, të cilat njihen edhe si molekulat e ngjyrës, në gjallesa.

Veç kësaj, sytë e njeriut kanë gjithashtu një strukturë të përshtatshme me këto qëllime. Arsyeja pse qelizat konike që shtrihen në retinën e syve tanë perceptojnë tri ngjyrrat themelore-e kuqe, e gjelbër, dhe e kaltër- është për shkak të molekulave të veçanta të pigmenteve që ato përmbajnë. Detyrën më të veçanta që kryejnë këto pigmente është se ne shohim botën e ngjyrosur të shndërruar nga energjia e “ngjyrës” në dritë në impulse nervore. Kjo d.m.th., se çdo gjë që ne e shohim si ngjyrë është rezultat përfundimtar i këtyre pigmenteve që transmetojnë gjatësi valore të dritës që arrijnë trurin tonë si impulse nervore.¹¹

Shkallët e energjisë së dritës të dukshme i përgjigjen disa shkallëve të energjisë të nevojshme për aktivizimin e molekulave të pigmenteve që janë gjetur në lëkurat e qenieve të gjalla, apo në luspat, puplat, apo në leshin që mbështjellë lëkurën e tyre, dhe si rrjedhim janë formuar ngjyrrat e tyre.

Pra siç u pa, pigmentet, që janë prezentë edhe në qendrën vizuale edhe në trupin e qenieve të gjalla, janë në një harmoni e përkryer me sistemet e tjera trupore. Mungesa e një lloji partikular të molekulës së pigmentit apo prania e saj me e vogël se sa e nevojshme në qendrën vizuale të qenieve të gjalla bën që ato të mos i dallojnë ngjyrrat në ambientin e tyre.

Shtohet pyetja: si zhvillohen këto molekula të veçanta në lëkurën e qenieve të gjalla? Në do të mund të japim përgjigje duke bërë edhe disa pyetje. A i kanë zgjedhur qeniet e gjalla ngjyrrat e tyre duke qenë të njohura për karakteristikat e spektrit të veçantë të dritës që arrin në tokë dhe prandaj kanë zgjedhur molekulat e pigmenteve të veçanta? Sigurisht se mundësia e ndodhjes së një ko incidence të tillë është zero. Këto molekula specifike janë vendosur në

lëkurën e qenieve të gjalla me një dizajn të vetëdijshëm. Është evidente se as qeniet e gjalla nuk kanë mundur të zhvillojnë një proces të atillë, e as një koincidençë e rastësishme nuk ka mundur të ndikojë në formimin e tyre. Harmonia është në pyetje e para, e cila ka mundur të krijohet vetëm sepse Një Që ka Dashur ta krijojë atë, Një i Cili mban gjithçka nën kontrollin e tij. Allahu ka krijuar çdo qenie me karakteristika shumë të sofistikuara dhe të veçanta. Gjithçka, e gjallë apo e jo e gjallë, ka pigmente të përshtatshme për të. Pigmentet absorbojnë dritën duke e përzgjedhur atë sipas strukturës së tyre molekulare. Secili pigment nuk reagon ndaj dritës në mënyrë të njëjtë. Për këtë arsye, ajo nuk shënohet me reaksion të njëjtë kimik dhe të formojë ngjyrën.

Ne mund t'ia japim klorofilit, molekulat e pigmentit që u jep ngjyrën e gjelbër bimëve, si shembull. Këto pigmente absorbojnë gjatësi valore të caktuara që vijnë nga dielli dhe reflektojnë dritë që ka gjatësi valore që i përgjigjet ngjyrës së gjelbër.

Klorofilit, molekulat e pigmenteve në bimë, reflektojnë fotonet që duken të gjelbër për shkak të gjatësisë valore të tyre. Në të njëjtën kohë, energjia që është pranuar prej dritës së diellit i mundëson bimëve të prodhojnë karbohidrate, që janë një prej burimeve kryesore të ushqimit të gjitha qenieve të gjalla.¹² Pigmente të ndryshme reflektojnë ngjyra të veçanta në gjatësi valore të caktuara sipas karakteristikave të tyre molekulare dhe kështu shkaktojnë reaksione të ndryshme kimike.

Janë shumë lloje të pigmenteve në natyrë. Disa shembuj janë të mjaftueshëm të tregojnë se molekulat e pigmenteve janë të dizajnuara veçanërisht për jetën.

Shembuj të tipave të pigmenteve

Burimi mbrojtës i ngjyrës: Melanina

Sytë e qenieve të gjalla janë mjaft të ndjeshëm ndaj dritës dhe lehtë preken në mënyrë jo të favorshme. Ende, ne mund të shikojmë pa problem në drejtim të diellit dhe të shohim gjërat rreth nesh, duke iu falënderuar sistemeve mbështetëse të cilat në mënyrë të veçantë i ka krijuar Allahu. Një prej këtyre sistemeve mbështetëse është edhe grupi i molekulave të pigmenteve që janë prezentë në sy.

Siç është e ditur, ngjyrat e syve të qenieve të gjalla ndryshojnë. Ato të cilat ia japin ngjyrën syrit, përsëri janë pigmentet. Melanina është njëra prej këtyre substancave të pigmenteve që gjendet në sy dhe që i jep syrit ngjyrën. I njëjti pigment i jep ngjyrën edhe lëkurës dhe flokëve tuaja. Sidoqoftë, melanina siguron më shumë se ngjyrën. Hulumtuesit mendojnë se melanina, që ekziston në sy, se melanina ofron që të dyja, mbrojtje kundër efekteve të dëmshme të rrezeve të diellit, dhe zmadhimeve vizuale. Substanca melaninë, natyra e së cilës është në zgjidhjen e problemit të rrezeve të rrezikshme të dritës, më fortë e thith energjinë e lartë të dritës se sa atë të ultë. Kështu që ajo thith apo absorbon ultravjollce më fortë se të kaltërtën, dhe më fortë të kaltërtën se sa të gjelbërtën.¹³ Në këtë mënyrë, melanina siguron mbrojtje të thjerrëzës së syrit kundër rrezeve ultravjollce. Ajo i siguron mbrojtje gati optimale

¹²

¹³

retinës duke filtruar ngjyra të ndryshme në propozicion me aftësinë e sak të dëmtojë pëlhurën e retinës – në këtë mënyrë duke zvogëluar rrezikun e degjenerimit makular. Njerëzit me më shumë melaninë të syrit kanë më pak dukuri të degjenerimit makular; njerëzit me më pak melaninë të syrit kanë dukuri më të shpeshta të degjenerimit makular. Afro 15% e rezervës së melaninës në syrin tonë humbet gjatë moshës 40 vjeçare dhe afro 25% gjatë moshës 50 vjeçare. Roli i melaninës në mbrojtjen e syrit është kritik: oftalmologjistët raportojnë se melanina në syrin e njeriut zvogëlon rrezikun e degjenerimit makular të moshë.¹⁴

Siç kuptuam, çdo njëra prej funksioneve të substancës melaninë ne demonstroi një dizajn special të kësaj substance.

Përgjigja në pyetjen se si është krijuar një substancë kaq e përkryer është se do të ishte e pamundur se një substancë shumë funksionale me një strukturë kaq të përkryer të jetë krijuar nga koincidenca. Allahu ka krijuar substancën melaninë sikurse gjithë gjërat e tjera në univers, në mënyrë të veçantë me qëllim që tu shërbejnë njerëzve dhe të jenë të dobishme për njeriun.

Burimi i Ngjyrave të Gjalla

Karotenoidet (dhe lipokromet) janë molekula pigmentuese, të cilat janë të sintetizuara në bimë dhe të cilat reflektojnë ngjyrën e verdhë, të kuqe dhe të portokalltë. Shtazët mund t'i marrin këto pigmente vetëm nëse ushqehen me bimë.

Sfungjer helmues, krinoidea, trangujt helmues të detit dhe disa molusqe janë ose pjesërisht ose plotësisht të verdha, të kuqe apo të portokallta si rezultat i karotenoideve, të cilat janë po ashtu të pranishme në pjesët e verdha të krahëve të fluturave dhe në sqepat e shpendëve. Në insekte të caktuara, këto janë të emetuara nga gjëndra të veçanta, të cilat janë të verdha ose të kuqe. Interesant, këto kombinime janë të me ngjyrë të gjelbër të zbehtë ose edhe të pa ngjyrosura fare dhe merren në ngjyrën e verdhë të shndritshme në gjakun e insekteve helmuese. Karotenoidet nuk janë të dobishme vetëm si ngjyrim të alarmimit, paralajmërimit; në disa insekte ato vetvetiu transformohen në lëndë helmuese, në të cilat raste ato shërbejnë me qëllime të dyfishta, si armë të insektit dhe si sinjal.¹⁵ Me anë të këtij sistemi shumë të veçantë që e ka krijuar Allahu, shumë qenie vazhdojnë të lulëzojnë.

Deri tani, ne shkurtimisht kemi ekzaminuar vetëm disa prej tipave të pigmenteve ekzistuese në natyrë. Konkluzioni që kemi arritur deri tani në dritë është prezenca e një dizajni të përkryer që vetvetiu shfaqet në pigmente, në atomet që formojnë këto pigmente dhe në të gjitha që rezultojnë si ngjyra. Allahu, Pronari i fundit, themelor i këtij dizajni të jashtëzakonshëm, Zoti i botëve, na paraqitet neve me anë të mjeshtërisë unike në ngjyra në natyrë të cilën e krijoi Ai.

A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të kenë zemra me të cilat do të kuptojnë, dhe veshë me të cilët do të dëgjojnë? Pse në të vërtetë sytë nuk verbërohen, por verbërohen zemrat në kraharorë. (Suretu el Haxhxh: 46)

14

15

Gjuha e ngjyrave

Ashtu siç janë ngjyrat të vlefshme për njerëzit kur u japin kuptim gjërave që i rrethojnë ata, ashtu janë të domosdoshme për qeniet e gjalla të tjera për mbijetesë.

Qeniet e gjalla e kanë “gjuhën e ngjyrës” që punon në pajtim me dritën dhe sistemet e perceptimit që ata kanë.

Ngjyra të ndryshme mund të kenë domethënie të ndryshme për çdo qenie të gjallë. Në mënyrë të mbijetojnë, çdo qenie e gjallë duhet të njeh gjuhën e ngjyrave në atë vendbanim, sepse funksionet jetësore mund të kontrollohen vetëm me anë të njohjes së gjuhës së tyre.

Pra, si e shfrytëzojnë qeniet gjuhën e ngjyrave?

Së pari, shumica e qenieve të gjalla kanë nevojë për ndihmën e ngjyrave në mënyrë që të gjejnë ushqimin. Së dyti, ngjyrat ekzistojnë në përpunime si lëkura, luspa, dhe lesh, dhe luajnë një rolë të rëndësishëm në kontinuitetin e jetës së tyre në saje të karakteristikave të tyre të absorbimit apo shpërndarjes të nxehtësisë. Veç kësaj, qeniet e gjalla shfrytëzojnë ngjyrosjet e tyre që të mbrohen prej armiqve të tyre. Si pasojë e ngjyrave që harmonizohen me vendbanimin e tyre, ata mund të maskohen dhe të fshehën prej armiqve të tyre. Alternativisht, ngjyrosja dhe modeli i tyre mund të sjellë imazh dekurajues për armiqtë e tyre. Ngjyrat po ashtu ndihmojnë kafshët të njohin miqtë dhe zogthat e tyre. Zogu nënë, p.sh., kupton se zogthat e saj a dëshirojnë apo nuk dëshirojnë ushqim nga ngjyra e gojës së tyre gjatë hapjes. Njëjtë, zogthat njohin nënën e tyre në këtë mënyrë dhe kuptojnë se ka arritur ushqimi.¹⁶ Siç u pa në këta shembuj në natyrë, qeniet njerëzore kanë nevojë të njohin domethëniet e ngjyrave në mënyrë që të mbijetojnë. Në mënyrë që ta arrijnë këtë dituri ata duhet të zotërojnë sistemet të përshtatshme për perceptim.

Nëse ata nuk i kanë këto sisteme, ata nuk do të jenë në gjendje të ndjejnë gjërat që i rrethojnë apo të përkujdesen për aktivitetet vitale të tyre. Ata nuk do të jenë në gjendje të njohin ushqimin e tyre apo të dallojnë armiqtë e tyre. Prandaj, në këtë rast më vonë ata do të dalin nga bota e jashtme dhe do të ishin pre e dënuar për vdekje.

Sigurisht, askush nuk mund të deklaroj se një sisteme të tilla të sofistikuar janë krijuar nga koincidenca. Çdo sistem, çdo harmoni, çdo dizajn, çdo program, çdo plan, çdo balancim duhet të krijohet nga krijuesi. Patjetër se ekziston një urdhër me i lartë dhe forcë që ka vendosur në mënyrë të përkryer këtë harmoni në qeniet e gjalla dhe në vendbanimet në të cilat ato jetojnë. Pronari i kësaj forcë rrethon që të dyja rrethinën dhe qeniet e gjalla vetvetiu dhe sistemet i shfrytëzon me një njohuri të lartë. Pronari i kësaj force është Allahu, Zoti i botëve.

Kur ekzaminojmë qeniet e gjalla, ne shohim sa shkathët ato përdorin gjuhën e ngjyrave. Këtu janë disa shembuj të gjuhës së ngjyrave, të cilët kanë një vend të rëndësishëm në jetën e qenieve të gjalla:

Maskimi

Maskimi është një prej taktikave mbrojtëse më efikase që përdorin kafshët. Kafshët vet maskuese janë nën një farë mbrojtje sepse strukturat e trupave të tyre, janë krijuar në harmoni të shkëlqyer me vendbanimet e tyre. Trupat e këtyre kafshëve janë aq të ngjashme me mjedisin e tyre ku jetojnë sa që kur të shikosh në fotografitë e tyre, është gati e pamundur të tregosh se nëse janë ato bimë apo kafshë, apo të dallojmë nga njëra tjetra se a është kafshë apo bimë prezentë në atë mjedis.

Krijesat e gjalla që adaptojnë ngjyrosjen e tyre në bazë të mjedisit ku jetojnë gjithmonë kanë tërhequr vëmendjen e shkencëtarëve dhe kanë qenë atraktive për ta. Kërkimet janë fokusuar në përgjigje në pyetjen se si një krijesë e gjallë mund të duket plotësisht njëjtë me një krijesë tjetër që ka kompletë një strukturë të ndryshme.

A keni menduar ndonjëherë, për shembull, si bretkosa, që, duke ecur në kopsht, të cilën e mendoni se është gjethe, dhe në momentin e fundit kur ju ecni largohet duke shpëtuar nga shkelja mbi të, ka mundur të fitoj këtë model dhe këtë ngjyrë? Maskimi është një mekanizëm shumë i rëndësishëm mbrojtës për bretkosën. Bretkosa e cila është e pavënëre në mjedisin e saj lehtë i humb armiqtë.

Derisa një merimangë roze në një lule rozë mund të fitojë hije të ndryshme roze, një tjetër anëtar i po atij lloji të merimangave mund të adaptohet në një ngjyrë të një luleje tjetër, për shembull, të verdhë, kur ngjitet në të.

Derisa dikush është duke shikuar në degë, duke menduar se asgjë nuk ka në të, një flutur mund të fluturoj prej degës krejtësisht papritur. Kjo flutur, që duket saktësisht si një gjethe e tharë e vjeshtës, një pjese e vyshkur vjeshte para një momenti, është një shembull perfekt për mrekullinë e maskimit.

Si do të shohim në faqet vijuese, ngjashmëria në mes krijesave të gjalla dhe objekteve në të cilat ato mbështeten pengon vrojtimin e tyre nga armiqtë. Është e kuptueshme se këto krijesa maskuese nuk e kanë krijuar veten e tyre, me iniciativën e tyre, të duken si gjethe, degë apo lule. Ç' është më tepër, ato as nuk janë të vetëdijshme se janë të mbrojtura për shkak këtyre ngjashmërive. Prapëseprapë, ato përdorin maskimin shumë shkathët në të gjithë shembujt tanë pa përjashtime. Një insekt ka ngjyrë të njëjtë me lule, një gjarpër që qëndron si një degë peme, bretkosa që i adaptohet ngjyrës së tokës së tharë, më shkurt, të gjitha krijesat vetë maskuese janë evidencë që vërteton se maskimi veçanërisht është krijuar si një taktikë mbrojtëse.

Asnjë krijesë nuk mund të ekzekuton një punë të tillë vetvetiu nga koincidenca. Saktësisht, Ai i Cili u jep krijesave të gjalla aftësinë që të maskojnë vetveten, dhe vendos procese kimike në to, procese të cilat me anë të cilave ato mund të ndërrojnë ngjyrën, është Allahu, i Gjithëdijshmi, i Gjithë mençuri.

Teknikat maskuese të zvarranikëve

Çfarë bën zvarraniku që të mbroj vetveten kundër grabitqarëve në shkretëtirë? Një prej mënyrave më të lehta për këto krijesa që lëvizin ngadalë përfundimisht është fshehja e tyre. Metoda më e mirë e fshehjes është adaptimi i trupit të krijesave në vendbanimin e tyre. Ngjyrat dhe modelet e tyre zakonisht u shërbejnë si jetë shpëtuese për shumicën e kafshëve. Për shembull, në një pyll është gati e pamundur të dallosh një gjarpër Rhino, një lloj të gjarpërinjve tropik që jetojnë në malet e shirave në Afrikë, për shkak të asaj se lëkura e tij është e mbuluar me modele gjeometrike të kaltërta, të kuqe, të verdha dhe të bardha. Është interesante, se ngjyrat e gjarpërit ngjajnë me rrethinën ku ata jetojnë. Kjo marrëdhënie një me një shkakton disa pyetje në mendjen tonë. Si u shfaqën këto ngjyra që janë aq të ngjashme me mjedisin? A është e mundur që kjo të ketë ndodhur me anë të gjasës, apo të jetë prodhuar nga vetë zvarraniku?

Saktësisht në përgjithësi është e pamundur. Është e pamundur se pari për zvarranikun të analizoj mjedisin, pastaj të vendos çfarë ndryshimesh i nevojiten ti bëj vetvetes, dhe në fund të përcaktoj ngjyrën dhe modelin. Veç kësaj, është totalisht e palogjikshme dhe e paarsyeshme të pretendojmë se ai (zvarraniku) ka krijuar një proces në trupin e tij që zhvillon reaksione kimike që janë të nevojshme për një ndryshim të tillë.

Edhe njeriu, qenia e gjallë e vetme e pajisur me arsye në tokë, nuk mund të ndërroj ngjyrën e asnjë pjese në trupin e tij. Ai nuk mund të krijoj një sistem në trupin e tij që të sjellë ndryshime të tilla. Në këtë rast, është vetëm një shpjegim për ngjashmërinë e përkryer të ngjyrës së zvarranikut me ngjyrën e rrethinës së tij i tillë që hapësirë edhe hija nuk ndryshon. Një krijues superior posedues i mençurisë së pafundme ka mundur të dizajnoj një krijesë të gjallë të këtillë. Ky dizajn i përket Allahut, të Plotfuqishmit.

Allahu është Ai i Cili i di më së miri nevojat e çdo qenie të gjallë.

Zvarraniku më i njohur i maskimit: Kameleoni

Keni parë ndonjëherë kameleonin duke ndryshuar ngjyrën e tij në ngjyrën e rrethinës së tij? Kjo është diçka që shihet e vlefshme. Kameleoni ka një aftësi të jashtëzakonshme të maskoj vetveten sa që shkathtësia e tij habit çdokënd. Megjithëse se edhe disa zvarranikë kanë aftësinë e ndryshimit të ngjyrës së tyre, askush nuk e bën atë aq shpejtë sa e bëjnë kameleonët.

Kameleoni përdorën zgarën e ngjyrave të kuqe dhe të verdhë, shtresat reflektuese të kaltërta dhe të bardha dhe më e rëndësishmja “chromatophores”, qelizat e lëkurës që u përgjigjen ndryshimeve në nxehtësi, dritë dhe në humorin, gjendjen shpirtërore të kafshës.³⁰ Nëse ju e futni një kameleon në një ambient shumë të verdhë, për shembull, ju do të shihni se menjëherë ngjyra e tij kthehet në të verdhë dhe i adaptohet rrethanave. Ç’është më tepër, kameleonët nuk i adaptohen vetëm një ngjyre, por po ashtu edhe substrateve të shumëngjyrshme. Fshehtësia e arritjeve të tyre është në qelizat e ngjyrave, që shtrihen nën lëkurën e këtij mjeshtri të maskimit, i cili në atë moment që e ndërron mjedisin në atë moment edhe adaptohet në atë mjedis. A mund kameleoni të bëj një adaptim kaq të përkryer vetvetiu? Si

këto krijesa bëhen të padallueshme duke u përzierë me mjediset ku ato jetojnë, derisa edhe artistët më të aftë duhet të punojnë me orë të tëra që të fitojnë ekuivalencën e një ngjyre të vetme natyrale?

Do të ishte e paarsyeshme të deklarojmë se kameleoni mund të demonstroj një akt të këtitllë me vullnetin e tij. Është e saktë se nuk është e mundur për një zvarranikë të përcaktoj dukjen e trupit të tij, e as të vendos sistem në trupin e tij të ndryshoj dukjen e tij. Do të ishte absurde të deklarojmë se kjo krijesë ka kontroll mbi tërë qelizat dhe atomet në trupin e saj, se është e aftë të bëj çfarëdo ndryshimi në to dhe të prodhojë pigmentet e nevojshme. Do të ishte kontradiktore dhe e pakuptimtë të deklarojmë se një kësi soj aftësie e jashtëzakonshme është krijuar nga shansi. Nuk ka mekanizëm në natyrë, që ka forcë të prodhojë një aftësi e përkryer të këtitllë dhe të ua dhuron qenieve që kanë nevojë për të. Ashtu si i ka krijuar të gjitha qeniet e gjalla në tokë, Allahu, ashtu i ka krijuar kameleonët. Allahu na demonstroi unitetin e mjeshtërisë së Tij në krijim me këta shembuj. Allahu është i Plotfuqishmi, i Gjithëdituri.

Allahun e lartësoi me adhurim ç'ka në qiej e në tokë dhe Ai është i gjithëfuqishmi, i urti. I Tij është pushteti në qiej e në tokë, Ai jep jetë dhe Ai jep vdekje dhe Ai ka fuqi për çdo send. (Suretu el-Hadidë:1-2)

Ndërrimi i ngjyrës sipas mjedisit

A shfrytëzojnë krijesat e gjalla ngjyrën vetëm për tu mbrojtur nga armiqtë e tyre? Sigurisht që jo. Disa kafshë mbrojnë veten e tyre edhe prej të ftohtit dhe nxehtësisë me anë të disa enzimave që u japin atyre ngjyrë të qimeve që mbulojnë trupin e tyre. Në disa kafshë që jetojnë në regjione të ftohta, qimet që mbulojnë këmbët, veshët dhe hundën, që janë pjesët më të ndjeshme të trupit, janë të ngjyrosura me ngjyrë të errët. Qimet e zeza sigurojnë më shumë energji të nxehtë për kafshët kështu që u ndihmojnë atyre të ngrohen me lehtë, mu sikur njerëzit që mundohen të përfitojnë nga dielli duke veshur rrobe të zeza dimrit. Ndryshimet e ngjyrës janë shumë të zakonshme për kafshët tokësore. Për shembull, në verë, leshi i dhelprave veriore kthehet në të bardhë, sepse temperatura në trupin e tyre është shumë e lartë. Në dimër, sidoqoftë, duke u ftohur koha, temperatura në trupin e tyre duke është në ulje dhe krijohet një mjedis më i përshtatshëm për punën dhe lëvizjen më të lehtë të enzimave. Për këtë arsye në dimër, leshi i dhelprave veriore errësohet. Lepujt, dhelprat, buklat dhe qelbësit që jetojnë në gjerësitë veriore në dimër kthehen në të kaftë dhe në dimër në të bardhë.

Derisa disa shpezë shndërrohen në totalisht të bardha në muajt e dimrit, ata në pranverë fitojnë një dukje krejt të re që i ngjan ngjyrës së tokës dhe vegjetacionit.

Ngjyrat alarmuese

Krijesat e gjalla shfrytëzojnë ngjyrën për qëllime të ndryshme. Shfrytëzimi i ngjyrës si mënyrë alarmimi është një prej këtyre qëllimeve. Në faqet vijuese ne do të u japim juve disa shembuj të kësaj vetie.

Ngjyrat në Shpezë

Një ndër tiparet kryesore të shumëngjyrëshmërisë së puplave të shpezëve është se ato pupla janë struktura jo të gjalla. Arsyeja pse një pupël përmban ngjyrën me përpikëri, edhe pasi të bie, është sepse ajo është e zhvilluar plotësisht si jo e gjallë.

Larmia e madhe e ngjyrave në shpezë në parim është për shkak të prezencës së pigmenteve në pupla, të cilat janë rezervuar, krijuar, në faza initiale të zhvillimit të puplës, apo të ndryshimeve të dritës të cilat ndodhin në varësi prej karakteristikave strukturale të puplave.

Që kur këto formacione, të cilat janë krijuar nga substanca keratinë, zhveshën për shkak të kushteve të mjedisit, ato rregullisht ripërtërirën. Kjo është sepse puplat e shpezëve vazhdojnë të rriten derisa të arrijnë gjatësinë e nevojshme, si dhe karakteristikat dhe modelet e tyre të llojit specifik.

Për shkak të strukturës së tyre të ndryshme, puplat mund të kenë dukje të ngjashme me xhamin prizëm që thyen dritën në ngjyra të ndryshme. Ngjyrat që formohen me anë të refrakcionit të dritës në këtë mënyrë, janë më të ndritshme dhe më metalike se ato që janë të formuara nga pigmentet. Ngjyrat e këtyre puplave ndërrohen nga të kaltër në të gjelbër, dhe nga portokalltë në të kuqe. Në përgjithësi, e gjelbërta, e kaltërta, dhe ngjyrat metalike në shpezë formohen me anë të reflektimit dhe refrakcionit të dritës. Akoma disa prej ngjyrave të puplave vijnë nga pigmentet.³⁹

Kryesisht gjenden tri pigmente kryesore në shpezë. Këto janë pigmenti melanin që prodhon ngjyrën e zezë, të kaftë apo të verdhë të zbehtë, pigmentet lipokrome që prodhon të kuqe, të verdhë apo të portokalltë, dhe karotenoidet. E kaltërta, e gjelbërta dhe disa ngjyra tjera të ndritshme në shpezë janë krijuar nga disa fluska mikroskopike në keratinën e puplave që thyejnë dritën. Puplat që absorbojnë gjithë spektrin e dritës dhe reflektojnë vetëm të kaltërtën, në anën tjetër, krijojnë ngjyrën e kaltër të disa shpezëve.⁴⁰

Hormonet gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në ndryshimin e ngjyrave në shpezë. Ndryshueshmëria e ngjyrës ndërmjet anëtarëve meshkuj dhe femra të disa llojeve shkaktohet nga hormonet seksuale. Ngjyrat e ndryshme dhe format e puplave të gjelit dhe pulës, për shembull, varen nga hormoni i estrogenit.

Ngjyrat e shpezëve janë të rëndësishme për adaptimin e tyre në mjedisin e tyre ashtu edhe për anëtarët meshkuj edhe për femra për identifikimin nga çdo i ardhur prej meshkujve të femrave në stinën e miqësisë. Veç kësaj, pigmentet, të cilat i japin ngjyrë puplave, shton forcën e puplave, rezervon energjinë që vjen nga dielli dhe parandalon rrezet e dëmshme ultravjollce nga depërtimi në trup.

Fluturat

Formimi i ngjyrës në krahët e fluturave është mjaft interesant. Drita reflektohet me anë të luspave në krahët e fluturave duke formuar ngjyra të cilat “për momentin janë jo-ekzistuese”,

39

40

por, të cilat shfaqin një simetri ekstraordinare dhe të mrekullueshme. Ne vetëm themi se ato “faktikisht janë jo-ekzistuese”, ju pyetni pse?

Fluturat janë të njohura për bukurinë e krahëve të tyre që janë sipërfaqet që janë relativisht më të gjëra se kraharoni i tyre. Si, atëherë, këto stile dhe ngjyra të mahnitshme në krahët e fluturave gjenden?

Fluturat kanë një palë të krahëve me cipë, të cilët në fakt janë të tejdukshëm. Që kur këta mbulohen me luspa të dendësive të ndryshme, tejdukshmëria e krahëve me cipë humb pa vënë re. Këto luspa rrisin cilësitë aerodinamike të krahëve të fluturave, dhe u japin atyre ngjyrën. Luspata, të cilat janë aq delikate sa që do të bien nga vendi i tyre posa të preken nga ndonjë gjë, kanë skaje të mprehtë dhe të ashpër të ngjitur për krahët e fluturës. Në këtë mënyrë, luspata mbesin të lidhur pa rënë. Secila prej këtyre luspave të vockla, të cilat duken sikur mbulojnë herpesin në kate, marrin një ngjyrë ose me anë të pigmenteve kimike ose me anë të refrakcionit të dritës që bie në ngjyrat e ylberit sikur siç bën flluska e sapunit.⁴¹ Veç kësaj, hulumtimet laboratorike se ngjyrat e ndryshme varen nga substanca të ndryshme kimike. Nënprodukti i substancës ngjyrosëse të quajtur pteridinë, p.sh., krijon ngjyrën rozë, të bardhë, dhe të verdhë që zakonisht vërehen në flutura. Melanina, që është një substancë ngjyrosëse e rëndomtë, ekziston në pikat e zeza në krahët e fluturës. Interesant, ngjyrat në krahët e fluturave nuk janë gjithmonë ashtu siç na duken. P.sh., luspata e gjelbërta në realitet janë përzierje në mes të luspave të zeza dhe të verdha. Hulumtimet e fundit të bëra në krahët e fluturave kanë demonstruar se pigmentet janë sintetizuar në luspa dhe që enzimat të nevojshme për prodhimin e melaninës gjenden në lëkurën e epërme të luspave.

Substancat ngjyrosëse nuk janë të shkaktuara vetëm nga këto shpërthime të larta në ngjyrat e fluturave. Struktura dhe rendi i luspave në krahët e fluturave shkaktajnë dredhi të ndryshme të dritës, siç është reflektimi, refrakcioni, dhe përfundimisht formimi i ngjyrave të bukurisë verbuese. Për shembull, fluturat *Stilpnotio Salicis* kanë luspa gjysmë-transparente, të cilat përmbajnë flluska. Ndonëse në luspa nuk ka substanca ngjyrosëse, drita që kalon në mes të luspave u jep fluturave pamje sikurse satine.

Sipërfaqja e luspave mbi krahët e fluturave *Argynnis* është pa besueshmërisë e butë, që krijon refleksione të argjendta. Në disa flutura, rregullimi i dy luspave njëra mbi tjetrën gjithashtu mund të krijoj refleksione të ndryshme të dritës, p.sh., duke bërë që flutura të duket e kaltër në vend që të duket e zezë apo ngjyrë kafe.

Kur ekzaminojmë strukturën e krahëve të fluturave edhe duke konsideruar vetëm ngjyrosjen e tyre, ne ndeshemi me shumë mrekulli. Ekzistimi i një bukurie të tillë të jashtëzakonshme pa dyshim është shenjë e forcës madhështore dhe mjeshtërisë së pafundme të Allahut, i Cili krijoi të gjitha këto.

Duhet të jetë caktuar se pranë këtyre qenieve të krijuara si zbukurim, ngjyrat dhe modelet në krahët e fluturave kanë edhe shumë funksione kritike për këto krijesa.

Sytë e gënjeshtërt të fluturave

Në shumë flutura, gjenden disa modele që zeza të neve kujtojnë në sytë e krijesave të mëdha. Këta sy, që prapë përbëhen prej luspave të ngjyrosura në krahë, mishërojnë një mekanizëm mbrojtës shumë të rëndësishëm për fluturat. Fluturat i mbajnë të mbyllur krahët e tyre gjersa pushojnë. Nëse ato takojnë një armik, apo janë të shqetësuar nga një prekje injorante, krahët menjëherë hapen, dhe një pikë-syri e madhe, e shndritshme dhe e ngjyrosur shumë shfaqet në sipërfaqen e krahut. Në këtë mënyrë, mesazhi i duhur i dërgohet grabitqarit.

Maskimi i fluturave

Vetitë maskuese të fluturave janë madhështore sikurse sytë e tyre të gënjeshtërt. Është ashtu sikurse fluturat maskuese shohin ngjyrën e shkurres, bëjnë vlerësimin e mjedisit, e analizojnë atë, dhe imitojnë ngjyrën e shkurres me ngjyrat që ato prodhojnë në sistemet e larta efektive të trupit të tyre. Qenie tjetër, e vetëdijshme për shijen e grabitqarit të tij, jep sinjale alarmuese tek ai duke imituar ngjyrat e prapësojnë atë duke i sugjeruar se flutura do të ketë shije të keqe ose edhe do të jetë helmuese. Është pa kuptim e mundur për një flutur që vetëm të shfaq këto akte. Ne mund ta sqarojmë atë me shembull:

Supozoni se jeni duke u munduar që të krijoni një ngjyrë në laborator. Nëse ju keni pak dije për këtë subjekt, ju nuk do të jeni në gjendje të arrini rezultatin e caktuar që e dëshironi, pa marrë parasysh pajisjet e përparuara dhe lehtësirat e laboratorit tuaj. Pastaj mendoni se jeni duke u munduar të arrini kualitetet e ngjyrave siç janë ato të fluturave, të cilat, me zhvillimin e ngjyrës dhe modelit të njëjtë sikurse në mjedis, bëhen gati të padukshme. Ju nuk do të jeni në gjendje të zhvilloni as vetëm një ngjyrë kuptimplote, shprehëse. Ekzistenca e një situatë të tillë, do të ishte sigurisht joshkencore dhe irracionale të i afrohem një deklarami që ky sistem i famshëm në flutura ka ardhur në ekzistencë me anë të rastit i lirë nga dizejnimi i vetëdijshëm.

Nëse diku ka një dizajn, aty ka edhe një dizajnuer. Dizajni i përsosur në tokë i përket Allahut, Mëshiruesit. Çka iu bie njerëzve të arsyeshem është të mendojnë dhe të nderojnë Allahun për atributet e krijimit në detaje. Në Suren an-Nahl, Allahu shpallë si vijon:

Edhe për atë që ju krijoi në tokë lloje të ndryshme (bagëti, bimë, pemë, minerale etj.): ka fakte për një popull që di të merrë përvojë. (Suretu en-Nahl:13)

Pikat e zeza që absorbojnë dritën

Në disa flutura, veçanërisht në pjesët e krahëve të tyre që janë afër trupit tyre, gjenden pika të mëdha të errëta që përbëhen prej luspave. Këto pika, që janë të vendosura simetrikisht në të krahët, kanë një funksion shumë të rëndësishëm për fluturat. Fluturat i përdorin këto pika në rend të arrijnë temperaturën e trupit të nevojshme për fluturim. Si e bëjnë këtë?

Luspat kanë karakteristikat të ndryshojnë nxehtësinë në nivelet minimale ose maksimale varësisht nga ngjyrat e tyre. Të gjithë ne i kemi parë fluturat duke hapur dhe mbyllur krahët nën diell duke u munduar të gjejnë këndin e saktë. Pikat e zeza në krahët e tyre i ndihmojnë këto flutura, të cilat mundohen të tërheqin dritën e diellit me anë të kësaj lëvizjeje.

Flutura që ka nevojë të ngrohë trupin e saj i hap dhe i mbyll krahët e saj ashtu që drita e diellit të bie drejtpërdrejtë në këto pika, dhe si pasojë të ngrohë trupin e saj.

Fluturat që jetojnë në vende të hapura të ekspozuara diellit kanë ngjyra më të lehta derisa ato që jetojnë në vende të pyllëzuara, me drurë, kanë ngjyra më të errëta.

Disa specie të fluturave Lepidoptera nuk kanë luspa në krahët e tyre, nuk mund të reflektojnë dritën, dhe kështu që janë transparente. Megjithëse është e mundur të i shohim fluturat duke fluturuar, është gati e pamundshme të i lokalizojmë kur ato zbresin ndokund. Kjo siguron një mbrojtje të përkryer për fluturat. Mu sikurse të gjitha krijesat tjera, fluturat janë krijuar me sisteme me anë të cilave ato mund të mbledhin gjitha gjërat e nevojshme për vete. Veç kësaj, të gjitha këto sisteme janë të ndërruar mes vete ku nuk mund të ekzistoj njëri sistem pa tjetrin.

Sikur të gjitha krijesat në gjithësi, Allahu i krijoi edhe fluturat me të gjitha detajet që ato posedojnë dhe i pajisi me sistemet që atyre u nevojiten.

Ngjyrat e Nëndetit

Jeta nën sipërfaqen e detit është shumë e ndryshme nga ajo në tokë. Të gjitha tiparet e krijesave me vendbanim ujor janë organizuar në atë mënyrë që ti mundësojë të jetojnë në ujë në mënyrën më të lehtë të mundur. Njerëzit nuk mund të shohin në ujë ashtu siç shohin peshqit, sepse syri i njeriut nuk ka ato tipare që do të i lejonin atij të realizoj shikim të mprehtë nën ujë. Syri i njeriut nuk ka sistemin e thjerrzës si atë të peshkut, dhe nuk është sferik dhe i fortë sikur ai i peshkut, kështu që ai nuk ka shikim aq të mprehtë si peshku nën ujë. Ai nuk mund të i lejoj aq precizitet sa i lejon peshkut për largpamësinë e distancave në ujë për shkak të refrakcionit, sikurse ai nuk llogaritë refrakcionin e dritës në ujë.

Allahu ka krijuar çdo qenie të gjallë me karakteristikat më të përshtatshme për ambientet jetësore të tyre. Krijesat që jetojnë nën det përbëjnë vetëm një pjesët të vogël të shembujve të mjeshtërisë së Allahut në krijim. Allahu nuk ka shok në krijim dhe gjithçka është nën kontrollin e Tij.

S'ka dyshim, ky është lajm i vërtetë. Nuk ka asnjë të adhurar tjetër pos Allahut. Allahu është ai, i plotfuqishmi, i vetëdijshmi. (Suretu Ali Imran: 62)

Dizajni i ngjyrave në bimë

Nëse njëri nuk reflekton, ai nuk mund të shoh karakteristikat të mbinatyrshe të qenieve të gjalla rreth tjetrës. Deri sa ai nuk mendon se si flutura fluturon me krahët e saj prej membrane, ai që nuk sheh se si lulet kanë diversion të tillë të ngjyrave, se si degët e drurëve qindra metra të gjatë mbesin të gjelbër, ai nuk mbërthej hollësitë e këtyre. Madje mjeshtëria e jashtëzakonshme në lule nuk mund të tërheq mendimit e atij.

Përderisa ne kontrollojmë në kudo në këtë libër, mjeshtëria e përkryer është shfaqur në të gjitha qeniet e gjalla që nga insektet deri te shpezët, që nga bimët deri te krijesat e detit. Saktësisht kjo mjeshtri i përket Allahut i Cili është Krijuesi i të gjitha qenieve të gjalla.

Le të mendojmë për bimët, frutat, lulet dhe pemët. Bimët, që të gjitha kanë ngjyra të ndryshme, aromat dhe shijet, janë dëshmi të mjeshtërisë të krijimit nga Allahu. Çdo bimë që ju e shihni rreth jush apo dini për të nga librat ka ngjyrat dhe modelet që janë të veçanta për atë lloj. Procesi i riprodhimit i të gjithave është i ndryshëm, proporcioni i nektarit që ato përmbajnë është i ndryshëm dhe po ashtu aromet e tyre të gjitha janë të ndryshme. Le të mendojmë për trëndafilat. Ato janë të kuqe, të bardha, të verdha, të portokallta, ngjyrë roze, të bardha të mprehta, dyngjyreshe, edhe trëndafila me ngjyra valë-valë. Saktësisht, do të ishte një verbërim i madh për njeriun që i sheh të gjitha këto dhe nuk ndjen admirim për dhe të mos sheh forcën e pafundme të Allahut, i Cili është Krijues i gjithë atyre luleve. Në Kuran, Allahu u drejtohet atyre që nuk arritën të çmojnë dëshmitë e krijimit që ata i shohin, si vijon:

Sa e sa argumente ka në qiej e në tokë, të cilët i shohin, por ata nuk i vështrojnë fare. Dhe shumica e tyre nuk beson ndryshe në Allahun, vetëm se duke i shoqëruar (zotëra të tjerë). (Suretu Jusuf:105-106)

A keni menduar ndonjëherë pse bimët janë të gjelbërta?

Sikur që është e qartë, ngjyrat që sundojnë në botën e bimëve janë e gjelbër dhe e gjelbër e errët. Klorofili është substanca kryesore që prodhon të gjelbërtën. Klorofili, një substancë shumë e rëndësishme, është pigment që përmban në kloroplaste të përhapura në citoplazmë të qelizës bimore. Këto pigmente lehtë absorbojnë dritën që vjen prej diellit, por reflektojnë vetëm ngjyrën e gjelbër. Veç të japin ngjyrën e gjelbër gjetheve, ky tipar gjithashtu shkakton përmbushjen e procesit kritik të quajtur “fotosintezë”.

Në fotosintezë, bimët marrin dritën e diellit, që përbëhet prej kombinimeve të shumë ngjyrave të ndryshme. Një prej karakteristikave më të rëndësishme të ngjyrave në dritën e diellit është se nivelet energjetike janë të ndryshëm prej njëri-tjetrit. Ky asortiment i ngjyrës quhet spektër, që është arritur nga refrakcioni i ngjyrave në prizëm për shembull, tonet e kuqe dhe të verdha kanë një kufi, dhe tonet e kaltra dhe vjollce kanë një kufi tjetër. Ngjyrat me nivele të larta energjetike janë ato ngjyra në kufirin e kaltër të spektrit.

Ndryshimi i niveleve të energjisë në mes të ngjyrave është shumë i rëndësishëm për bimët, sepse atyre u nevojiten sasi të mëdha të energjisë që të bëjnë fotosintezën. Për këtë arsye, gjatë fotosintezës, bimët absorbojnë ato rreze të diellit me energjinë më të lartë të niveleve energjetike ndaj rrezeve ultravjollce në kufi të spektrit, p.sh. vjollce dhe të kaltër, sikurse ngjyrat që janë më shumë ndaj infra të kuqe (ngrohta) në kufi të spektrit, p.sh. e kuqe, e portokalltë, dhe e verdhë. Gjethet kryejnë të gjitha këto procese përmes pigmentit klorofil që ekziston në kloroplaste.⁵²

Për bimën që të kryej fotosintezën, nivelet energjetike të grimcave të dritës që absorbohet nga substanca klorofil duhet të jenë adekuat, të njëjtë. Procesi i fotosintezës fillon

kur bima, me energjinë që e merr prej grimcave të dritës, ndan molekulat e ujit në molekula të oksigjenit dhe hidrogjenit. Hidrogjeni reagon me karbon në gazin e dyoksid karbonit nga lëngësira e bimës, që është esenciale për bimët që të mbijetojnë. Me fjalë të tjera, bima prodhon vetë ushqimin e saj. Oksigjeni i papërdorur, në anën tjetër, lëshohet në ajër. Shumica prej oksigjenit që ne e thithim në atmosferë prodhohet në këtë mënyrë.

Si rezultat i procesit të fotosintezës në bimë, ato prodhojnë karbohidrate, një prej burimeve kryesore të ushqimit për tjerat qenie të gjalla. Substancat që prodhohen gjatë fotosintezës janë jashtëzakonisht të rëndësishme për vetë bimët e edhe për kafshët dhe njerëzit, sepse bimët janë burim kryesor i ushqimit të të gjitha qenieve të gjalla në tokë.

Siç pamë, pranë sigurimit të shfaqjes estetike, ngjyra e gjelbër e bimëve është gjithashtu jashtëzakonisht kritike për mbijetesën e që të djave bimëve dhe krijesave tjera të gjalla. Allahu bën substancën klorofil për arsye të ushqimit të bimëve dhe për ushqimit e të gjitha krijesave tjera të gjalla.

Si ndodhin ngjyrat e ndryshme në bimë?

Si e përmendëm më lart, ngjyra e reflektuar nga çdo objekt varet në molekulat e pigmentit që ka ai objekt. Molekula bazale e pigmentit të gjelbër në bimë është substanca “klorofil” siç u tha edhe më herët. Veç kësaj, gjenden edhe pigmente tjera që prodhojnë ngjyrat e tjera në bimë, dhe këto lloje të ndryshme të pigmenteve formojnë llojllojshmërinë të jashtëzakonshme të ngjyrave që ne e shohim në bimë.

Për shembull, veç klorofilit, në bimë gjenden edhe pigmentet karotenoide. Disa prej këtyre pigmenteve, të cilat ne i kemi ekzaminuar në detaje më parë, janë të verdha dhe u japin ngjyrë veshëve të misrit, limonëve, kallamit të artë dhe lulediellit. Karotenoidet tjera janë më shumë të kuqe se sa të verdha; këto gjenden në rrepe, domate, trëndafila, dhe karota. Karotenoidet po ashtu janë prezentë edhe në gjethe të gjelbërta. Pastaj një mrekulli e fortë: pse gjethe nuk duken të kuqe, të verdha apo të portokallta, por më së shumti në hije të së gjelbërtës, të gjelbërta të errëta? Arsyeja është se e gjelbërta e klorofilit është aq e fortë sa që ngjyrat tjera nuk mund të shihen.⁵³

Sidoqoftë, ndryshimet ndodhin në vjeshtë. Kur orët e ditës vijnë duke u shkurtuar, bimët ndalin së prodhuari klorofilin, dhe forca e pigmenteve që prodhojnë ngjyrën e gjelbër bie, duke bërë që ngjyra e gjelbër e bimëve të zbehet dhe të humb. Karotenoidet tani bëhen të dukshme, ngjyrosin gjethet me ngjyrë kafe, të verdhë, dhe të kuqe.

Po ashtu në vjeshtë, një grup i pigmenteve i quajtur “antocianine” formohet në shtresat e jashtme të gjetheve të caktuara. Këto pigmente, të cilat janë të kuqe dhe të verdhë, që të dyja të ndritshme, kombinohen me pigmentet e tjera dhe u japin gjetheve ngjyra të kuqe të thellë dhe vjollce që ne nganjëherë i shohim.⁵⁴

Informata që u jepet të gjitha pigmenteve që u japin ngjyrë bimëve është e koduar në ADN-në e bimës. Për këtë arsye, qeniet e bimëve bartin të njëjtat karakteristika pa marrë

⁵³

⁵⁴

parasysh ku gjenden, në të tërë botën. Për shembull, kudo në botë ngjyra e portokajve është e njëjtë; forma dhe struktura e lëvores së tyre është e njëjtë. Ngjyra e membranës transparente, që gjendet brenda lëvores së portokallit, dhe që formon qeska të vogla të mbushura, të ngjyrosura me të portokalltë, të parfumuara me ujë sheqeri, kurrë nuk ndryshojnë askund në botë. Bananet gjithkund janë të verdha, domatet të kuqe, dhe trëndafiltë, vjollce, dhe kuqe të thellë janë të një ngjyre kudo që gjenden ata. Kudo që do të shkonit në botë, ju nuk do të shihni një dredhëz natyrale duke u rritur me një ngjyrë të ndryshme. Kudo në botë, ADN-ja e dredhëzave përmban karakteristikat që i bëjnë ato dredhëza që ne i njohim. Ngjyra, era dhe shija e dredhëzave janë gjithmonë të njëjtat. Është një rend unik, i pakrahasueshëm. Saktësisht, nuk mund të pretendohet se një sistem i këtillë ka ardhur në ekzistencë nga shansi i lehtë.

Pronari i kësaj mjeshtreje të pangjashme që mbizotëron në gjithë botën është Allahu, i Cili ka mençuri të pafundme. Allahu ka forcë mbi të gjitha gjërat.

A keni menduar ndonjëherë se si një llojlojshmëri e tillë e ngjyrave ndodhë në bimë megjithëse që të gjitha ato rriten në të njëjtën tokë dhe ujiten me të njëjtin ujë?

Në Suren ar-Ra'd, Allahu tërheq vëmendjen në faktin se megjithëse të gjitha ujiten me të njëjtin ujë, të korrura të ndryshme dalin nga toka:

E në tokë, copa sipërfaqesh, të ngjitura njëra me tjetrën, kopshte të hardhisë, të mbjella dhe hurma që janë degëzuara në shumë trupa dhe jo të degëzuara e të gjitha ujiten nga një ujë, dhe Ne shijen në ngrënie të frutave të tyre e kemi dalluar njëren prej tjetrës. Edhe kjo dëshmon me argumente për njerëzit e mençur. (Surja er-Rra'd:4)

Ashtu si Allahu na tërheq vëmendjen tonë, na le neve të mendojmë, duke shikuar të gjitha perimet dhe frutat rreth nesh, çfarë të korrura të ndryshme dalin nga e njëjta tokë. Për shembull, le të shikojmë në pjepër, shalqinj, kivi, banane, vishnje, patëllxhanë, domate, hardhi, pjeshka, dhe fasule të gjelbër. Kur qëroni lëvoren e verdhë të errët të bananeve, nga ajo del banania me ngjyrë të verdhë më të zbehtë me aromën e saj të pakrahasueshme. Lëvroja e kuqe, e gjelbër ose e verdhë e mollëve ka shkëlqim të lëmuar. Njerëzit nuk mund të imitojnë kualitetin e nuhatjes dhe shijes, aromë të veçantë me të, prej lëngut të saj të ëmbël.

Pastaj, dikujt mund t'i bëhet pyetja: si gjithë këto lule, pemë, perime dhe fruta kanë aq shumë ngjyra të ndryshme megjithëse ato dalin prej të njëjtës tokë të thatë? Kjo është dëshmi e diturisë të pafundme të Allahut dhe krijimit të Tij pa i paraprirë asnjë model. Është e pamundur për njeriun që të krijoj një ngjyrë të re. Të gjitha ngjyrat të prodhuara nga njerëzit janë vetëm kopje të ngjyrave origjinale që ekzistojnë në natyrë. Sidoqoftë, Allahu është Krijuesi, dhe krijimi i të gjitha ngjyrave që përshkruajnë krijesat e gjalla në tokë është i Tij. Mjeshtëria e Allahut në krijim e pangjashme. Njëri prej emrave të Allahut, i Gjithëfuqishmi, al-Musawwir – Ai i Cili formon krijesat e Tij në forma të ndryshme. Allahu krijon gjithçka Ai krijon në formën më të përkryer.

Ai është Allahu, Krijuesi, Shpikësi, Formësuesi. Të tij janë emrat më të bukur. Atë e madhëron çka ka në qiej e në tokë dhe Ai është ngadhënjyesi, i urti. (Surja el-Hashr:24)

Ngjyra dhe shfaqja e të gjitha bimëve në tokë është krijuar në atë mënyrë që të joshë shpirtin njerëzor. Në fruta dhe perime, aty është një llojlojshmërie e pangjashme e ngjyrave. Në anën tjetër, kur ne mendojmë për lulet dhe pemët ne prapë shohim të njëjtën shfaqje estetike dhe llojlojshmëri të ngjyrave.

Aty kemi edhe një dizajn të patejkalueshëm të ngjyrave dhe modeleve në lule. Secila prej qindra mijërave lloje të luleve ka qenë e pajisur me karakteristika të posaçme të veçanta për atë lloj. Sot, parfumet, modelet dhe ngjyrat që prodhohen nga burrat që të gjitha janë imitime të homologeve origjinale në natyrë. Për shembull, ngjyra vjollce e gjetheve të manushaqes, të cilat janë të buta si kadife, dhe smoothness e sipërfaqes të gjetheve të tyre është e pangjashme. Pëlhurat e buta janë prodhuar në imitim të thurjes së manushaqeve, por cilësi e njëjtë kurrë nuk mund të arrihet.

Me këtë afrim, pa marrë parasysh çfarë bimë në tokë ne ekzaminojmë, përfundimi në të cilin arrijmë është krijimi i përkryer. Allahu, i Cili nuk ka shoq në krijim, krijoi bimët për njerëzit me shije, aroma, ngjyra dhe forma të ndryshme. Çka na bie neve është të reflektohem në vazhden e ka krijuar Allahu dhe të jemi mirënjohës.

Tema e evolucionit nuk mund të sqaroj: Harmoninë dhe simetrinë

Në tokë ne jetojmë dhe në universin e gjerë në të cilin është e lokalizuar toka mbizotëron një harmoni e shkëlqyeshme. Madje edhe duke shikuar nga dritarja, ne shohim shumë shembuj të kësaj harmonie. Në re, në qiell, pemë, lule, kafshë dhe në shembuj të ngjashëm, është e dukshme renditje dhe simetri e përkryer.

Kur ne shikojmë në natyrë, ne shohim se çdo bimë dhe çdo kafshë ka ngjyrat dhe modelet e posaçme për llojin e tyre. Për më tepër, secila prej këtyre ngjyrave dhe modeleve kanë domethënie të ndryshme për qeniet e gjalla: ftesa për miqësi, shprehja e agresivitetit, alarmimi ndaj rrezikut dhe shumë nocione tjera si këto mësojnë kuptim në mes të kafshëve prej perceptimit të ngjyrave dhe modeleve.

Teoria e evolucionit, e cila pretendon se gjithçka ka ardhur në ekzistencë prej një koincidence të rastësishme, ka hasur në qorrsoak, për arsye se mjeshtëria, llojlojshmëria e ngjyrave dhe harmonia u shfaqën në natyrë. Çarls Darvini, themeluesi i teorisë në formën që ne e kemi sot, gjithashtu ka të rrëfej për situatën që ai fytyroi sepse dizajni është i qartë në qeniet e gjalla. Darvini shpalli se ai nuk mund të kuptonte pse ngjyrat e krijesave të gjalla kanë kuptime të ndryshme:

Vështirësia është, pse gjakpirësit nganjëherë janë aq mrekullueshëm dhe me mjeshtri të ngjyrosur? Kur shihet se shumica janë të ngjyrosur tu ikin rrezikut, unë mezi kuptoj ngjyrën e tyre të ndritshme në çështje tjera të shoh gjendjet e tyre fizike. Nëse ndonjë prej të objektuarave flutura mashkullore është bërë e bukur me anë seleksionimit seksual, dhe është pyetur pse ata nuk janë bërë të bukur sikurse larvat e tyre, çfarë përgjigje do të jepnit? Unë nuk do të mund të përgjigjem por do të duhej të vazhdoja hulumtimet.⁵⁵

Çarls Darvini prapë tregon për konfliktin me vet teorinë e tij sikurse vijon:

Unë vlerësoj rastet e ngjyrë-shndritshmëve, peshqve mashkullor inkubator, dhe femrave flutura brilante, duke treguar se vetëm një gjini ka mundur të bëhet brilante pa ndihmën e transferimit të bukurisë nga gjinia tjetër; megjithëqë unë nuk mund të supozoj se bukuria në gjininë tjetër është bërë nga seleksionimi.⁵⁶

Saktësisht, është e pamundur për ngjyrat, rendin dhe simetrinë në natyrë të keni ardhur në ekzistencë nga seleksionimi natyror. Në këtë pikë, do të ishte e dobishme që të shikojmë në konceptin e “seleksionimit natyror” të parashtruar nga teoria Darwiniste e evolucionit. Siç dihet mirë, seleksionimi natyror është njëri prej mekanizmave imagjinar të teorisë së evolucionit. Ai thotë se ata të adaptuar më së miri në ambientin jetësor të tyre do të mbijetojnë, derisa ata që janë të dobët dhe të papërshtatshëm me ambientin jetësor të tyre do të eliminohen, zhduken. Sipas deklarimeve të evolucionistëve, një ndërrim mirëbërës ndodh në anëtarët e qenieve të

55

56

ndryshme me anë të mutacionit të rastësishëm në gjenet e tyre. Krijesa është përzgjedhur në mesin e të gjitha të tjerave të atij lloji me anë të mekanizmit të mbijetesës e më të shëndetshmit, dhe ajo që ishte mutacion i rastësishëm është transferuar në sasi të mëdha në gjeneratën e ardhshme.

Përfundimisht është e pamundur për ngjyrat, modelet dhe simetritë në modelet e qenieve të gjalla të jenë krijuar me anë të një mekanizmi të këtillë. Ky është një fakt shumë i qartë. Megjithëse ai është themeluesi i teorisë, vetë Darvini duhet të pranojë se mekanizmi imagjinar i seleksionimit natyror nuk mund të jetë shkaktar për një rend të këtillë. Gjithashtu, arkeologu britanik J.Hawkes pyet për seleksionimin natyror të pakuptimtë fare, në artikullin e tij në “Nine Tantalizing Mysteries of Nature”, të botuar në magazinën *New York Times*:

Unë e shoh të vështirë të besoj se bukuritë të tepërta të shpezëve, peshqve, luleve dhe gjitha formave tjera të gjalla janë prodhuar vetëm nga seleksionimi natyror; Unë e shoh të pabesueshëm se vetëdija njerëzore ishte një prodhim i tillë. Si mundet truri i njeriut, instrumentin me të cilin u krijua të gjitha pasuritë e civilizimit, të cilat e shërbyen Sokratin, Shekspirin, Rembrandin, dhe Ajnshtajnin, të kenë ardhur në ekzistencë nga lufta për mbijetesë në mes të gjahtarëve të lojës së egër në labirintin e epokës së akullnajave, pleistocen?⁵⁷

Siç e kuptuam nga ato prova të evolucionistëve, ata e dinë se teoria e tyre është në krizë. Është e paarsyeshme të mbrojmë idenë në bazë të së cilës qeliza, me sa duket ka ardhur në ekzistencë me anë të ko incidencës si rezultat i ndezjeve dhe shiut në tokë, është kthyer në gjëra të gjalla të shumëngjyrëshe nëpër kohë. Të supozojmë për shembull, shkencëtari të merr një qelizë të vetme të bakteries, të ia siguroj kushtet më të përshtatshme laboratorike, të përdorë gjithë pajisjet që i nevojiten, të bëjë përpjekje që të evoluoj këtë qelizë për miliona vite (gjë që është e pamundur, vetëm të supozojmë atë); çka do të mësojë ai në fund? A do ta transformojë ndonjëherë bakterin në pallua me a ngjyrat e saj verbuese, apo në leopard me modelet e përkryera në trupin e tij, apo në trëndafil me gjethet e saj të buta të kuqe? Sigurisht, njerëzit inteligjent nuk munden madje as të imagjinojnë një gjë të tillë, e lere më të bëjnë një deklaram të tillë. Akoma, ky është pikërisht pretendimi, deklarata e teorisë së evolucionit.

Qorrsokaku i ngjyrës në evolucion

Le të vërtetojmë me anë të një shembulli se është e pamundur për ngjyrat e qenieve të gjalla dhe sistemet e transformimit të ngjyrës të bëhen nga seleksionimi natyror. Le të marrim si shembuj kameleonët. Kameleonët janë kafshë të afta për adaptim në ngjyrat që janë prezentë në mjedisin e tyre dhe në ndërrimin e ngjyrave sipas mjedisit. Derisa pushojnë në gjethe të gjelbërta, ata marrin ngjyrën e gjelbër, derisa lëvizin nëpër fushë ngjyrë kafe, lëkura e tyre ndërron në të kaftë në një kohë shumë të shkurtër. Le të mendojmë së bashku se si ndodhin këto procese.

Krijesat e gjalla ndërrojnë ngjyrën si rrjedhim i proceseve shumë të ndërlikuara që ndodhin në trupin e tyre. Është e pamundur për njeriun të ndryshoj as ngjyrën e trupin e as

ngjyrën e qenieve tjera të gjalla, sepse trupi i njeriut nuk është i pajisur me sisteme përkatëse për një operacion, proces të tillë. E as nuk është e mundur për njeriun që të zhvilloj një sistem të tillë vetvetiu sepse ky sistem nuk është sikur një pjesë e pajisjeve që duhet të zhvillohet dhe të instalohet. Shkurtimisht, për një krijesë e gjallë të ndryshojë ngjyrën, është e nevojshme të jetë krijuar me një mekanizëm të atillë që të ndryshojë ngjyrën.

Le të mendojmë për kameleonin e parë në tokë. Çka do të ndodhte po që se ai nuk do të kishte aftësinë të ndryshojë ngjyrën? E para, kameleoni do të ishte kafshatë e lehtë pasi që ai nuk do të mund të fshihej. Veç kësaj, pasi që do të ishte e lehtë të vërehej, gjuetia do të ishte shumë e vështirë për atë. Kjo përfundimisht do të shkaktonte që kameleonit ti mungojë çfarëdo mekanizmi mbrojtës, pastaj të vdes apo të ngordh nga uria dhe, më vonë, të zhduket fare nga faqja e dheut. Akoma, ekzistenca e kameleonëve në botë sot, jep prova se një ngjarje e tillë kurrë nuk ka ndodhur. Kështu, kameleonët kanë pasur këtë sistem të përkryer prej momentit të paraqitjes së tyre në tokë .

Evolucionistët thonë se kameleonët kanë zhvilluar këtë sistem përgjatë kohës. Kjo bën që shumë pyetje të sillen në mendjet tona : pse kameleonët zgjodhën një zhvillim kaq kompleks të përshtatjes së ngjyrave nga një mekanizëm i lehtë mbrojtës? Pse zgjodhën ndërrimin e ngjyrave kur ka shumë mënyra tjera të mbrojtjes? Si ka mundur të krijohet një mekanizëm në kameleonë, një mekanizëm që siguron të gjitha proceset e nevojshme për ndryshimin e ngjyrës? A është e mundur për një zvarranikë që të mendojë një mekanizëm të tillë dhe më pas ta zhvilloj sistemet e nevojshme në trupin e tij? Më tepër, a është e mundur për një zvarranikë që dekodojë informatën e nevojshme për ndryshimin e ngjyrës, informata e cila gjendet në qelizat e ADN-së?

Padyshim, kjo është e pamundur. Konkluzioni që do të dal nga përgjigjet në pyetjet e mësipërme është do të jetë një dhe i njëjti konkluzion siç vijon: është e pamundur për krijesat e gjalla të zhvillojë një sistem aq kompleks që i lejon atyre të ndërrojnë vetvetiu ngjyrën e tyre.

Nuk ndryshojnë vetëm sistemet e ngjyrave, por edhe diversioni dhe modeli i ngjyrës në krijesat e gjalla meriton vëmendje. Është e pamundur për ngjyrat e shndritshme në papagaj, diversionin e ngjyrave në peshq, simetrinë në krahët e fluturave, modelet fascinante në lule dhe ngjyrat në gjallesat tjera të jenë formuar nga vetë ato. Modelet, figura dhe ngjyra aq të përkryera, të cilat shërbejnë për qëllime shumë të rëndësishme në jetët e gjallesave tjera, janë evidenca konkrete të krijimit. Është më se e qartë se për rreth nesh nuk ekziston ndonjë dizajn superior në formimin e ngjyrave.

Le ta qartësojmë këtë me një shembull: le të supozojmë se ne jemi duke dizajnuar një prodhim që përbëhet nga katrorët. Madje të vizatojmë vetëm një prej tyre, ne duhet të bëjmë një kalkulim të vogël dhe të sigurohemi se të katër anët janë lineare dhe të barabarta dhe katrori ka kënde prej 90 shkallëve në secilin kënd. Ne mund ta vizatojmë katrorin vetëm pasi të bëjmë disa kalkulime dhe rregullime. Siç pamë, madje vetëm të vizatojmë një katror kërkon ca dituri dhe mjeshtri.

Le të përdorim arsyetimin e njëjtë për gjallesat rreth nesh dhe të mendojmë në to. Aty gjendet një harmoni e përkryer, një rend dhe një plan në qeniet e gjalla. Personi i cili çmon

domosdoshmërinë e diturisë dhe mjeshtërisë në vizatimin e një katrori të thjeshtë, menjëherë do të kuptoj që origjina e rendit, harmonisë, ngjyrave dhe dizajnit në univers është produkt i një dije dhe mjeshtërie të pafundme. Prandaj nuk ka baza të arsyeshme ose shkencore që të deklarojnë se një sistem i tillë si ai në univers është krijuar nga rastësia. Allahu, Më i Fuqishmi, ka krijuar gjithë universin. Allahu është i Vetmi i Cili që i jep formë të gjithave, Ai krijon më të bukurën.

Simetria në natyrë nuk mund të fillojë nga rastësia

Një prej pikave më të rëndësishme që prodhon harmoninë në univers është simetria. Gjërat e gjalla kanë strukturë simetrike. Gjithë çka që shohim në natyrë, për shembull një farë, një frutë apo një gjeth që ne ekzaminojmë do të na tregojë simetrinë në strukturën e tyre. Le të marrim një bimë me gjethe. . Ky është një tip i saktë i simetrisë. Ngjashëm, rregull i dukshëm rregullon renditjen grimcat e farës dhe në dizajnimin e venës së gjethit.

Krahët e fluturës janë një shembull tjetër i simetrisë në natyrë. Në të dy krahët e fluturës janë hijet e ngjyrave të njëjta dhe modelet e njëjta. Modeli në një krahë është prezent po ashtu në krahun tjetër saktësisht në të njëjtin vend.

Ne mund të shohim shumë shembuj të simetrisë rreth nesh, disa prej të cilëve i kemi përmbledhur më poshtë. Sidoqoftë gjëja më e rëndësishme është se kemi vetëm një përfundim të përbashkët nga të gjithë shembujt e dhënë. Kemi një rend të pangjashëm, apo të jemi më të qartë, në këto gjëra të gjalla është paraqitur një mjeshtri madhështore. Një prej evidencave të faktit se universi nuk ka mundur të vijë në ekzistencë është ky rend i mprehtë dhe kjo mjeshtri. Në librin e tij, *“The teory of Evolution and Bigotry”*, Prof. Cemal Yildirim tregon këtë fakt edhe pse vetë ai është evolucionist:

“Është larg nga bindja të ua atribuojmë këtë rend qenieve të gjalla, të cilat duket të mos kenë qëllime të veçanta, për rastin apo koincidencën”.⁵⁸

Allahu krijoi gjithçka në univers me një rend shumë të lartë. Allahu ka kontroll mbi të gjitha gjërat.

Zoti juaj është një, Allahu, nuk ka zot pos Atij që është mëshirëplotë, gjithnjë mëshiron. Është fakt se në krijimin e qiejve e të tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon Allahu prej së larti e me te ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe përhapë në te nga çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara mes qiellit e tokës, për një popull që ka mend ka argumente. (Suretu El-Bekare: 163-164)

Përfundimi

Kur një njeri i mençur dhe i vetëdijshëm shikon për rreth, ai menjëherë do të shoh faktin e krijimit. Kjo është ashtu që Allahu krijoi gjithçka për neve që të dimë për Atë dhe mendojmë për atë që Ai krijoi.

Për një person që e ka të zhvilluar kuptimin, do të ishte plotësisht joracionale të deklaroj se balancimet delikate që përbëjnë jetën kanë ardhur nga “rastësia”. Për çdo pjesë që punon në ndërvarësi të formojë këtë rend ka një rol jashtëzakonisht ekstrem në të procesin e përgjithshëm. Ngjyrat e gjallesave, të cilat janë subjekte të materies në këtë libër, janë një prej komponentëve më të rëndësishme në rendin e universit.

Siç pamë në shembujt e dhënë më par, ngjyrat, modelet, njollat, e madje edhe vijat në krijesat në natyrë kanë një domethënie. Ngjyrat, nganjëherë të përdorura si mjete komunikimi, nganjëherë si rreziqe për grabitqarët, kanë një rëndësi jetike për qeniet e gjalla. Kjo është aq e madhe sa që ndriçimi dhe errësira në hijet e ngjyrave të krijesave, dhe madje drejtimin i vijave të tyre është vendosur në mënyrë të veçantë.

Një syçelë menjëherë do të shoh se jo vetëm qeniet e gjalla por gjithashtu edhe gjithçka tjetër në natyrë është ashtu siç duhet të jetë, çdo qenie është në vendin më të përshtatshëm për të. Për më tepër, ai do të kuptoj se gjithçka i është thënë në shërbim njeriut. E kaltërta, ngjyra freskuese e qiellit, dukja plotë ngjyrëshe e luleve, pemët në gjelbër të ndritshme, kullosat, hëna, e cila ndriçon botën në errësirë të zezë, yjet dhe gjitha bukuritë tjera që ne nuk mund të i numërojmë janë manifestime të mjeshtërisë së Allahut.

Allahu krijoi gjithçka në univers dhe gjithçka të gjallë dhe të pa jetë aty të përsosur. Allahu ka kontroll mbi të gjitha gjërat: Ai është më i Fuqishmi, Fuqiploti.

Ky është Allahu, Zoti juaj, nuk ka të adhuruar përveç Tij, Krijues i çdo sendi, pra adhuroni Atë; është mbikëqyrës ndaj çdo sendi. (Suretu El En'amë: 102)

Pas gjithë atyre subjekteve të përfshira në këtë libër, çka i bie dikujt që ka një kapje të fuqisë dhe të mjeshtërisë së pafundme të Allahut, është të kthehet drejt zotëruesit të vërtetë të të gjitha këtyre bukurive dhe të drejtoj jetën e tij që do ta pëlqej vetëm Ai.

Fshehtësia përtej materies

Prej momentit kur njeriu vjen në jetë, ai është subjekt i arsimimit të vazhdueshëm të shoqërisë. Një pjesë e këtij arsimimi, ndoshta pjesa kryesore e tij, kap që realiteti është gjithë çka mund të preket me dorë dhe që shihet me sy. Ky nënkuptim, që është me mjaft influencë në shoqëri, është transmetuar si i padiskutueshëm nga gjenerata në gjeneratë.

Një moment mendimi, pa qenë subjekt i asnjë arsimimi, sidoqoftë do të realizonte një fakt mahnitës:

Prej momentit kur ne vijmë në jetë, gjitha gjërat që na rrethojnë thjeshtë janë ato që ndjenjat tona na i paraqesin neve. Bota, qeniet njerëzore, kafshët, lulet, ngjyrat e këtyre luleve, aromat, frutat, shijet, planetët, yjet, malet, gurët, ndërtesat, dhe gjithësia; shkurt, gjitha këto

gjëra janë perceptime që ndjenjat tona na i paraqesin neve. Që ta sqarojmë më shumë këtë subjekt, do të ishte e dobishme të flasim për ndjenjat, agjentët që na pajisin me informatat për botën e jashtme.

Perceptimet tona të shikimit, dëgjimit, nuhatjes, shijes dhe prekjes, të gjitha funksionojnë në mënyrë të ngjashme me njëra-tjetrën. Imazhet e shijes, aromës, zërit, shikimit, dhe ngurtësisë që ne i pranojmë prej objekteve që ne supozojmë se ekzistojnë në botën e jashtme janë të gjitha të transmetuara me anë të neuroneve në qendrat relevante në tru. Kështu që, atë që truri i pranon janë impulse nervore. Për shembull, gjatë procesit të shikimit, thërrmijat e dritës (fotonet) që udhëtojnë prej objektit në sy kalojnë nëpër thjerrëz përballë syrit ku aty ato janë thyer dhe bien të kthyer në retinë në pjesën e pasme të syrit. Impulset nervore të prodhuara në retinë pranohen si imazhe në qendrën vizuale në tru pas një serie të proceseve. Dhe ne, në pjesën e trurit tonë të quajtur qendër vizuale, që zë vend prej vetëm disa centimetra kub, pranojmë një botë të ngjyrosur, të ndritshme që ka thellësi, lartësi dhe gjerësi.

Sistem i ngjashëm funksionon edhe në të gjitha ndjenjat tjera. Shijet, për shembull, kthehen në impulse nervore me anë të qelizave të veçanta në gojë dhe në gjuhë dhe transmetohen në qendrën relevante në tru.

Një shembull do ta qartësonte këtë subjekt. Le të supozojmë se në një moment ju jeni duke pirë një gotë limonadë. Freskia dhe ngurtësia e gotës që ju e mbani është shndërruar në impulse nervore me anë të qelizave të veçanta nën lëkurën tuaj dhe është transmetuar në tru. Njëherësh, aroma e limonadës, shija e ëmbël që ju e keni provuar dhe ngjyra e verdhë që ju e shihni kur shikoni në gotë të gjitha janë transmetuar në tru në formë të impulseve nervore. Zhurma që ju e dëgjoni kur e lëshoni gotën në tavolinë është pranuar ngjashëm me anë të veshit tuaj dhe është transmetuar në tru si një sinjal elektrik. Qendrat ndijore në tru, që në thelb janë të ndryshme, ende punojnë në kooperim me njëra tjetrën, interpretojnë të gjitha këto perceptime. Si rezultat i këtij interpretimi, ju supozoni vetën tuaj se jeni duke pirë një gotë limonade. Me fjalë të tjera, gjithçka ndodhë në qendrat ndijore në trurin tuaj derisa ju mendoni se gjitha këto perceptime janë të ngurta.

Sidoqoftë, në këtë pikë ju jeni të mashtruar që kur nuk keni evidenca të supozoni se atë që e pranoni në trurin tuaj ka material të lidhur jashtë kafkës tuaj.

Subjekti që u shpjegua deri më tani është i qartë dhe është vërtetuar nga shkenca sot. Çdo shkencëtar do të ua tregoj juve mënyrën se si punon ky sistem dhe që bota në të cilën mendojmë se po jetojmë është një grumbull perceptimesh. Një fizikan anglez, John Gribbin konstaton me anë të relacioneve të interpretimit se truri bën që ndjenjat tona janë si interpretime të stimulimeve që vijnë nga bota e jashtme, sikur që është një pemë në kopsht. Ai vazhdon dhe thotë se truri ynë pranon stimulime që janë të filtruara me anë të ndjenjave tona, dhe që pema është vetëm stimuluese. Pastaj ai pyet: Kështu që, cila është reale? Pema që është formuar nga ndjenjat tona, apo pema në kopsht?⁵⁹

Padyshim, ky është realiteti që kërkon të menduar të thellë. Deri më tani, është krejtësisht e mundur që ne supozojmë se çdo gjë që ne shohim në botën e jashtme ka një realitet absolut. Sidoqoftë, pasi që shkencën po ashtu vërteton, nuk ka mënyrë që të vërtetojmë objektet kanë materiale që lidhen me botën e jashtme. Subjekti që shkurtimisht u shpjegua këtu është njëri prej më të rëndësishmëve që ju mund ta realizoni në jetën tuaj.

Miliona të ngjyrave në vend të errësuar tmerrësisht

Kur ne e konsiderojmë këtë thellësisht, ne përplasemi në materie mjaftë mahnitëse. Truri, në të cilin qendrat tona nervore janë të lokalizuara, është vetëm një pjesë mishi që peshon 1.400 gram. Dhe kafa, një sasi e eshtrave, mbron këtë copë mishi. Kjo është një mbrojtje që nuk mund të depërtoj as drita, as zhurma e as aromën e çfarëdo lloji. Në brendi të kafkës është një errësi e sterrë dhe e izoluar plotësisht prej çfarëdo drite dhe ere.

Sidoqoftë në këtë hapësirë të errët, ne pranojmë një botë shumëngjyrëshe me miliona të shijeve, aromave dhe zërave. Si ndodh gjithë kjo?

Çfarë ju bën të ndjeni dritën në këtë errësi të sterrë? Çfarë ju bën ndjeni aromën në një vend të izoluar prej çfarëdo ere? Në mënyrë alternative, çfarë ju bën që të ndjeni ndjenjat tjera? Kush i krijoi gjitha këto ndjenja për ju?

Faktikisht, në çdo moment ndodh një mrekulli. Siç përmendet më lart, të gjitha perceptimet e një dhome ku gjendemi ne, për shembull, janë të shndërruara në impulse nervore dhe të transmetuara në trutë tanë. Ndjenjat të transmetuara në trurin tonë janë të interpretuara si imazhe të dhomës. Me fjalë tjera, ju jeni, në të vërtetë, ju brenda një dhome që ju supozoni se jeni në; por në të kundërtën, dhoma është brenda juve. Lokacioni i dhomës mbetet në tru, apo më mirë të themi, lokacioni i cili është perceptuar në tru është i vogël, i errët dhe vetëm një njollë. Sidoqoftë, peizazhet e gjëra që ne i shohim në horizont disi janë po ashtu brenda kësaj njolle të vogël. Ju i perceptoni që të dyja në vendin e njëjtë, edhe dhomën edhe peizazhin gjërë.

Për më tepër truri prapë është ai që interpreton dhe atribuon domethënien e sinjaleve që ne supozojmë se janë në “botën e jashtme”. Për shembull, le të konsiderojmë ndjenjën e dëgjimit. Faktikisht është truri ynë ai që transformon valët e zërit në “botën e jashtme” në simfoni. Kjo është për të thënë, muzika gjithashtu është perceptimi i krijuar nga truri ynë. Në mënyrë të njëjtë ne i shohim ngjyrat, ato të cilat arrijnë në trutë tanë janë thjeshtë impulse nervore të karaktereve të ndryshme. Prapë është truri ynë që i transformon këto sinjale në ngjyra. Nuk ka ngjyra në “botën e jashtme”. As molla nuk është e kuqe, as qielli nuk është i kaltër, e as pema nuk është e gjelbër. Ato janë ashtu siç janë sepse ne i perceptojmë të jenë ashtu. “Bota e jashtme” varet kryesisht nga perceptuesi.

Madje edhe defekti më i vogël në retinën e syrit shkakton verbërimin për ngjyra. Disa njerëz pranojnë të kaltërtën si të gjelbër, disa të kuqen si të kaltër, dhe disa të gjitha ngjyrat si hije të ngjyrës hiri. Në këtë pikë, nuk është me rëndësi nëse objekti jashtë është i ngjyrosur apo jo.

Mendimtari i mirënjohur Berkeley po ashtu adresoi këtë fakt:

Në fillim, mendohej se ngjyrat, aromat, etj., “përnjëmend ekzistojnë” por më pas këto shikime u braktisën, dhe shihej se ato ekzistojnë në varësi prej ndjenjave tona.⁶⁰

Përfundojmë, se arsyeja që ne i shohim objektet e ngjyrosura nuk sepse ato janë të ngjyrosura ose sepse kanë material të pavarur në ekzistencën e tyre jashtë vetvetes së tyre. E vërteta është e materies është se më tepër se të gjitha cilësitë që ne u atribuojmë objekteve janë brenda neve dhe jo në “botën e jashtme”.

Kjo ndoshta është diçka për të cilën nuk keni menduar kurrë deri më sot.

Çka është jashtë neve?

Deri më tani biseduam për faktin se ne jetojmë në kafkën tonë dhe pranojmë më shumë se që pranojmë ndjenjat tona. Tani le të lëvizim një hap para. “Gjërat që ne i perceptojmë a kanë ekzistencë aktuale apo janë imagjinare?”

Le të fillojmë duke pyetur: a ekziston nevoja për botën e jashtme në mënyrë që të shohim apo dëgjojmë?

Jo. Nuk ka nevojë për botën e jashtme që të shohim dhe të dëgjojmë. Nxitja e trurit në çfarë do forme shkreh në funksion të gjitha ndjenjat, duke formuar ndjenja, vizione dhe zhurma. Shembulli më i mirë për të shpjeguar këtë është ëndrra.

Derisa ëndërroni, i shtrirë në krevatin tuaj, në një dhomë të errët dhe të qetë, sytë e juaj mbyllën fort. Asgjë nuk ju prek juve që ju ta pranoni, as drita as zhurma. Sidoqoftë në ëndrrat tuaja, nga përvoja shumica prej jush mendojnë se jeni në një aventurë të jetës ditore, aq gjallërisht dhe pastër sikur në gjendje të zgjuar. Në ëndrrat e tuaja, ju po ashtu zgjoheni dhe vraponi për në punë. Alternativisht, në ëndrrat tuaja ju shkon në pushime dhe ndjeni diellin e verës.

Veç kësaj, gjatë rrjedhës së ëndrrave tuaja, ju nuk ndjeni dyshim për atë që e shihni. Vetëm kur të zgjoheni atëherë ju kuptoni se gjithë ajo ishte ëndërr. Në ëndrrat tuaja, ju frikësoni, shqetësoni, gëzoheni ose pikëlloni. Njëkohësisht, ju provoni ngurtësinë e materies. Sidoqoftë, nuk ekziston asnjë burim që i prodhon këto perceptime. Ju ende jeni në një dhomë të errët dhe të qetë.

Descartes për këto fakte mahnitëse të ëndrrave konstaton se:

Në ëndrrat e mia, unë shoh se bëj gjëra të ndryshme, shkoj në vende të ndryshme; kur zgjohem, sidoqoftë, unë shoh se nuk kam bërë asgjë, nuk kam shkuar askund, dhe se qetësisht gjendem i shtrirë në shtratin tim. Kush do të më siguron mua se unë nuk ëndërroj në kohën ekzistuese, e edhe më shumë, se e gjithë jeta ime nuk është ëndërr?⁶¹

Në këtë rast, ashtu siç pamë në ëndrrat tona si të vërtetë dhe vërtetuam se gjithë ajo ishte vetë një botë imagjinuese kur u zgjuam, ne nuk mund të deklarojmë se ato që i përjetojmë pasi të zgjohemi janë reale. Kështu që, krejtësisht është e mundur që, ne në çdo kohë mund të zgjohemi nga jeta në tokë, që ne mendojmë se jemi duke jetuar në, dhe mund të fillojmë të përjetojmë jetën reale. Ne nuk kemi dëshmi me të cilat do ta mohonim këtë. Në të kundërtën,

⁶⁰

⁶¹

zbulimet e shkencës moderne shtuan seriozisht dyshimet për kërkimet se atë çka ne e përjetojmë në jetën tonë të përditshme ka ekzistencë aktuale.

Në këtë rast, ne përballemi me materien e qartë; derisa ne mendojmë se kjo botë në të cilën jetojmë ekziston, nuk ka vend për të bazuar këtë supozim. Është krejtësisht e mundur që këto perceptime të mos kenë lidhje materiale.

A janë trutë tanë të ndarë nga bota e jashtme?

Nëse gjëja ne mendojmë se bota materiale thjesht përmban perceptimet që na shfaqen neve, atëherë çka është truri, me të cilin dëgjojmë, shohim dhe mendojmë? A nuk është truri, si çdo gjë tjetër, një koleksion prej atomeve dhe molekulave?

Si çdo gjë tjetër ne e konsiderojmë “lëndën”, trutë tanë janë gjithashtu perceptime, dhe sigurisht jo shkarkime. Pas të gjithave, trutë tanë janë gjithashtu pjesë të mishit që ne i pranojmë përmes ndjenjave tona. Si çdo gjë tjetër ne pretendimi se ekzistojmë në një botë të jashtme, është vetëm një imazh për ne.

Kështu që, kush i pranon të gjitha këto? Kush sheh, dëgjon, nuhat dhe shijon?

Të gjitha këto na përballojnë neve me diçka të qartë: qenie njerëzore që sheh, ndjen, mendon dhe është i ndërgjegjshëm është më shumë se vetëm shuma e atomeve dhe molekulave të cilat e përbëjnë trupin e tij. Çka e bën njeriun qenie njerëzore aktualisht është shpirti që ia ka dhuruar Allahu. Në të kundërtën, atributi i ndërgjegjes dhe gjithë attributeve njerëzore dhe aftësive të një pjese të mishit prej 1.5 kg do të ishte përfundimisht joracionale, jo të mendojmë se kjo pjesë e mishit është vetëm iluzion.

Ai që përsosi krijimin e çdo sendi, e krijimin e njeriut e filloi nga balta. Pastaj bëri që pasardhësit e tij të rrjedhin prej një pike uji të dobët. Mandej, Ai e formëson atë dhe nga ana e vet i jep shpirt atij deh Ai është që juve ju pajis edhe me dëgjim, me të parit e me zemër, e pak send është ajo që ju falënderoni. (Suretu es-Sexhde:7-9)

Pasi që njeriu nuk është akumulim i materies por “ruh-shpirt”, atëherë cili është ai që paraqet, apo ta bëjmë më të qartë që “krijon” dhe paraqet, koleksion të perceptimeve të quajtur “materie” e shpirtave tanë?

Përgjigja në këtë është e qartë: Allahu, i Cili “fryn” shpirtin e Tij në qeniet njerëzore, është Krijuesi i çdo gjëje që na rrethon. Burimi i vetëm i këtyre perceptimeve është Allahu. Asgjë nuk ekziston pos asaj që krijoi Ai. Në rreshtat vijues Allahu rrëfen se Ai përherë krijon gjithçka dhe në të kundërtën, asgjë nuk do të ekzistonte:

Allahu i mban qiejt e tokën që të mos zhduken, e nëse ato zhduken, s’ka askush pos Tij që mund t’i mbajë; Ai është që nuk ngutet, është që fal. (Suretu Fatir:41)

Si rezultat i rrethanave të vazhdueshme njerëzit që nga koha kur lindin, mund të mos jenë të gatshëm ta pranojnë këtë fakt. Ende, s’ka gjë se si ata i largon dëgjimit apo shikimi të tij,

është një fakt i qartë. Të gjitha imazhet shfaqin njeriun si krijesa të Allahut. Për më tepër, jo vetëm bota e jashtme por të gjitha veprimet që i ndodhin vetvetiu çdo kujt ndodhin vetëm me dëshirën e Allahut. Çdo veprim i pavarur dhe i ndarë prej dëshirës së Allahut nuk vjen në shprehje.

... e Allahu ju krijoi juve edhe atë që e punoni. (Suretu es-Safatë:96)

... ju nuk i mbytët ata, por Allahu i mbyti ata, dhe ti nuk i gjuajte kur i gjuajte ata, por Allahu i gjuajti... (Suretu el-Enfalë:17)

Si rezultat i të gjithave ne kuptojmë se qenia e vetme absolute është Allahu. Nuk ka asgjë pos Tij. Ai rrethon gjithçka në qiej, në tokë dhe gjithçka në mes tyre. Allahu rrëfeu në Kur'an se Ai është gjithkund dhe që Ai i rrethon të gjitha gjërat:

Vini re! Ata janë ne dyshim për takimin me Zotin e tyre, e ta dini se Ai ka përfshirë dijen e vet çdo send. (Suretu Fussilet: 54)

Të Allahut janë edhe lindja edhe perëndimi, dhe kahdo që të ktheheni, aty është anë e Allahut. Vërtetë, Allahu është i gjerë e i dijsëm. (Suretu el-Bekare: 115)

Vetëm të Allahu janë ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë. Allahu ka përfshirë çdo send. (Suretu en-Nisa: 126)

Kur Ne thamë: “Zoti yt ka përfshirë (me dijen e Vet) të gjithë njerëzit”. (Suretu el-Isra: 60)

Kursija e Tij përfshinë qiejt dhe tokën, kujdesi i tij ndaj të dyjave nuk i vjen rëndë, Ai është më i larti, më i madhi. (Suretu el-Bekare: 255)

Allahu të rrethon ty përballë, shpinë, djathtas, majtas, kjo është, nga çdo drejtim; Ai i Cili është dëshmitar për çdo moment të juaj, gjithkund, është tërësisht në kontroll të brendësisë dhe jashtësisë tuaj, dhe më afër juve se vena e qafës juaj është Allahu, i Plotëfuqishmi, vetëm Ai.

**Thanë:”Ti je i pa të meta! Ne nuk kemi dije tjetër përveç atë
Na e mësove Ti. Vërtetë Ti je i Gjithëdijshmi, i Urti.”
(Suretu el-Bekare: 32)**

FUTNOTAT

1. Bilim ve Teknik Dergisi (Journal of Science and Technics), March 1985, p.23
2. Jillyn Smith, Sense and Sensibilities, Willey Science Edition, p. 60-61
3. F.Press, R. Siever, Earth, New York:W.H.Freeman, 1986, p.4
4. Michael Denton, Nature's Destiny, The Free Press, 1998, p.51
5. Ian M.Campbell, Energy and Atmosphere, London: Wiley, 1977, p.1-2
6. Encyclopedia Britannica, 1994, 15th ed. Vol.18, p.203
7. Michael Denton, Nature's Destiny, The Free Press, 1998, p.55
8. Bilim ve Teknik Dergisi (Journal of Science and Technics), No: 366, p.81
9. Bilim ve Teknik Dergisi (Journal of Science and Technics), October 1986, p.6
10. Bilim Teknik Dergisi (Journal of Science and Technics), October 1986, s.6-9
11. Franklyn Branley, Color, From Rainbows to Lasers, Thomas Y. Crowell Comp., New York, p.23-28
12. Temel Britannica Ansiklopedisi, Vol 7, p. 16
13. <http://www.netxpress.com/~ppt/story.htm>
14. <http://www.netxpress.com/~ppt/story.htm>
15. Marco Ferrari, Colors for Survival, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.110
16. David Attenborough, The Life of Birds, Princeton University Press, New Jersey, 1998, p.263
17. Marco Ferrari, Colors for Survival, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.22
18. Marco Ferrari, Colors for Survival, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.52
19. Marco Ferrari, Colors for Survival, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.20
20. Marco Ferrari, Colors for Survival, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.38
21. Marco Ferrari, Colors for Survival, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.71
22. Marco Ferrari, Colors for Survival, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.77
23. Jill Bailey, Mimicry and Camouflage, BLA Publishing Ltd., England, 1988, p.17
24. Marco Ferrari, Colors for Survival, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.85
25. Marco Ferrari, Colors for Survival, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.25
26. Marco Ferrari, Colors for Survival, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.38
27. Marco Ferrari, Colors for Survival, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.48-49
28. Marco Ferrari, Colors for Survival, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.43
29. Marco Ferrari, Colors for Survival, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.86-87
30. International Wildlife, September-October 1992, p.34
31. Jill Bailey, Mimicry and Camouflage, BLA Publishing Ltd., England, 1988, p.18
32. Marco Ferrari, Colors for Survival, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.109
33. Marco Ferrari, Colors for Survival, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.64
34. Marco Ferrari, Colors for Survival, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.130
35. Marco Ferrari, Colors for Survival, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.129

36. Marco Ferrari, *Colors for Survival*, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.126
37. David Attenborough, *The Trials of Life*, Princeton University Press, New Jersey p.235
38. Marco Ferrari, *Colors for Survival*, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.109
39. David Attenborough, *The Life of Birds*, Princeton University Press, New Jersey, 1998, p.158
40. David Attenborough, *The Life of Birds*, Princeton University Press, New Jersey, 1998, p.158
41. Ranger Rick, May 1999
42. Marco Ferrari, *Colors for Survival*, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.55
43. National Geographic, October 1989, p.518
44. The Guinness Encyclopedia of Living World, 1992, p.167
45. Marco Ferrari, *Colors for Survival*, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.56
46. Marco Ferrari, *Colors for Survival*, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.122
47. Marco Ferrari, *Colors for Survival*, Barnes and Noble Books, New York, 1992, p.62
48. Karl Roessler, *Coral Kingdoms*, Harry N. Abrams, Inc., Publishers, 1986, p.44
49. National Geographic, December 1996, p.118-120
50. Karl Roessler, *Coral Kingdoms*, Harry N. Abrams, Inc., Publishers, 1986, p.125
51. Solomon, Berg, Martin, Villie, *Biology*, Saunders College Publishing, 1993, p.192-193
52. Temel Britannica Ansiklopedisi, Vol. 7, p.16
53. Franklyn Branley, *Color, From Rainbows to Lasers*, Thomas Y. Crowell Comp., New York, p.37
54. Franklyn Branley, *Color, From Rainbows to Lasers*, Thomas Y. Crowell Comp., New York, p.38
55. Francis Darwin, *Life and Letters*, Vol.II, p. 275
56. Francis Darwin, *Life and Letters*, Vol.II, p. 305
57. J. Hawkes, *Nine Tantalizing Mysteries of Nature*, New York Times Magazine, 1957, p.33
58. Cemal Yıldırım, *Evrım Kuramı ve Bađnazlık (The Theory of Evolution and Bigotry)*, Bilgi Yayınevi, January 1989, p.108
59. Tařkın Tuna, *Uzayın Ötesi (Beyond Space)*, p.194
60. *Treaties Concerning the Principle of Human Knowledge*, 1710, Works of George Berkeley, vol.1, ed.A. Fraser, Oxford, 1871
61. Macit Gökberk, *Felsefe Tarihi (History of Philosophy)*, p.263